

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi THASH&THEM

së shpejti...
TELEVISIONI MË I RI
INFORMATIV NË SHQIPËRI
A1 REPORT!
 origina e lamit...

MARREVESHJA E KONCESIONIT / Kush fshihet pas kompanisë izraelite "Emanuelle Adriatic"

ISH-SPUNI NA MORI NAFTEN

"Fitoi vetëm 128 mijë UDS në 2011"

Zbulohen letrat e pronarëve të rinj të tre blloqeve me naftë dhe gaz në detin Adriatik. Firma e paregjistruar në Qipro dhe në Shqipëri. Pas saj ish-zyrtari i Mosadit dhe tregtar i armëve në Izrael

"THASH&THEM" ▶ Faqe 13-20

Ledion Liço: Do të jem sërish moderatori në "The voice"

Jeta private dhe pushimet e çmendura në New York

Lajmi

Firma "Emanuelle Adriatic", e cila mori me vendim të qeverisë shqiptare tri blloqe me naftë dhe gaz në detin Adriatik, ka patur një bilanc qesharak vitin e shkuar dhe pas saj fshihet Jakov Nimrod, ish-zyrtar i lartë i MOSAD-it izraelit në vitet '80.

TI RANE
GENC KONDI

Pronari i kompanisë që ka marrë me koncension tre blloqe të kërkimit dhe shfrytëzimit të naftës dhe gazit natyror në detin Adriatik nga qeveria shqiptare është një figurë kyç e spiunazhit ndërkom-bëtar dhe tregtar i njohur armësh. Jakov Nimrodi është presidenti i nderit i grupit... ▶ vijon në faqe 2

TEKSTI REVOLTUES ▶ Faqe 5

Sms-në për Berishën e bëri themeluesi i PD në Vlorë

Ish-punonjësi i prefekturës: I kam çuar shpeshherë mesazhe

Editorial

NGA ARBEN RROZHANI

Kalaja e pamposhtur e qeverisë

Kryelajmi i dy ditëve të fundit ka qenë Lazarati. Drejtpërdrejt, ato dhjetra punëtorë mëditës, shumica gra, që shkojnë të mbjellin lëndën narkotike në fshatin famëkeq, e që kapen nga policia ndërsa nisen drejt kalasë që kundërmon era narkotikë. Nuk është çudi që sot të ketë raportime të tjera për ndalime punëtorësh ndërsa të hipur në furgonë duan të hyjnë për të punuar. Është ekonomi tregu, kërkesë-ofertë. Lazaratit ofrojnë punë dhe ata ofrojnë krahun e punës, për 2 mijë lekë të reja, që është shumë në këto kohë krize.

Qeveria këtu është përfaqësuar nga policët që... ▶ vijon në faqe 7

TERHEQJA ENIGMATIKE

Kulisat, kush e rrëzoi Topallin

Pasiguria për mbështetjen në Kuvend sposti zgjedhjen te emri i Nishanit

TI RANE
JAKIN MARENA

Berisha ka hequr dorë nga kandidatura e kryetares së Kuvendit, njëherësh nënkryetare e PD për ta futur në garë si Presidente të Republikës jo për shkak të dëshirës së tij për të pasur një president konsensual, pasi atë se kishte në mendje që në fillim, pavarësisht kandidatëve jopolitikë që hodhi në treg... ▶ Faqe 5



PIRO LUTAJ ▶ Faqe 4

"Tani nga Sali Berisha pritët çdo gjë"

Deputeti i PS: Nano asnjë shqetësim, është në fatin e tij

Koment

NGA JANEZ POTOÇNIK*

Në Rio për të zgjedhur të ardhmen

Pas më shumë se një javë, liderët botërorë do të mbledhen në Brazil për Samitin Rio+20 për të vendosur mbi të ardhmen që duam. Njëzet vite pas samitit të parë mbi tokën, tema është ekonomia e gjelbër në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe uljes së varfërisë. Përse është e rëndësishme kjo konferencë dhe përse këto aspirata për një ekonomi të gjelbër? Ekonomia e gjelbër është ajo që reflekton përmirësim të mirëqenies së njerëzve dhe barazisë sociale, duke reduktuar në mënyrë domethënëse rreziqet mjedisore dhe problemet ekologjike. Rritja dhe zhvillimi... ▶ vijon në faqe 6

EUROPIANI ▶ Faqe 22

Anglia dhuron spektakël, Franca s'ndalet

NERANXI

... gjithmonë një hap përpara...

Shurupë për kokteile dhe likerëra për bare dhe restorante

Adresa: Autostrada Tirane- Durrës, km 7, Yrshak Tirane; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax: 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com



Kusari-Lila: Çimentoja "shqiptare" nga Serbia e Greqia

Mer përmasa të tjera "lufta e çimentos" midis Kosovës dhe Shqipërisë. Sipas ministres kosovare Kusari-Lila, Shqipëria ka dëmtuar tregun kosovar, duke hedhur në të, jo vetëm çimento të prodhuar në Shqipëri, por edhe çimento të prodhuar në vende të tjera. Ministria mbrojti vendimin e saj për vendosjen e tarifës prej 35 për qind

për çimenton e importuar nga Shqipëria dhe vendet e tjera, me arsyetimin se në tri vitet e fundit është rritur importi i këtij produkti në treg nga 3 në 35%. Diçka e tillë ka prekur tregun e çimentos, duke dëmtuar më së shumti fabrikën e vetme të prodhimit të çimentos në Kosovë "Sharr Cem". "Kjo është një masë e përkohshme 90-

ditore. Nëse vërtetohet që ka një praktikë që prish tregun në Kosovë, masa mund të zgjatet", deklaroi Kusari-Lila. Sipas ministres, problemi nuk është vetëm te fabrika e prodhimit në Fushë Krujë, por në të njëjtën kohë Shqipëria importon edhe çimenton e prodhuar jashtë saj. Një grup pune po heton mbi arsyet e importit në sasi të mëdha të çimentos në Kosovë.



Vizita

Sali Berisha u premtoi koncensionin izraelitëve në nëntor 2011

TIRANE

Më 22 nëntor 2011, kryeministri Sali Berisha, gjatë vizitës së tij zyrtare në Izrael, ka zhvilluar një takim të veçantë me përfaqësuesit e ILDC-Emanuelle Adriatic Energy, që u raportua dhe nga Kryeministria. Sipas këtij njoftimi, "ai ka krijuar një hapësirë të madhe takimeve me biznesin duke iu dhënë garanci të plota për të investuar në Shqipëri. Një takim të veçantë kryetari i qeverisë ka ofruar edhe për një prej kompanive më të mëdha të rajonit" për kërkimin e gazit dhe naftës në det, ILDC-Emanuelle Adriatic Energy", thuhet në njoftimin e zyrës së shtypit. Në këtë njoftim shtohet se kompania në fjalë kishitë gati një projekt investimi në breg-



detin shqiptar dhe "është një prej më të specializuarave në këtë fushë". Kryeministri garantoj presidentin e kompanisë izralite (Jakov Nimrodi), e cila kishte

nisur ndërkohë procedurat për investimet në vendin tonë, për "lehtësime në kryerjen e aktivitetit të saj në ujrat shqiptare".

Në takim ka qënë edhe Besjan Pesha, kreu i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, institucion i cili ka përgjegjësinë e zbatimit të projekteve në fushën e kërkimit dhe nxjerrjes së gazit. Kreu i qeverisë ka ftuar biznesin e këtij vendi që të investojë në Shqipëri në fushën e energjisë, bujqësisë apo fusha të tjera që kanë interes të përbashkët.

Nga ky njoftim të krijohet ideja se që atëhere izraelitët kishin sigurinë se do të merrnin lejen për të investuar në ujrat territoriale shqiptare. Megjithatë, do të kalonin disa muaj që kjo leje të pejej zyrtarisht.

Subjekti "Emanuelle Adriatic", i paregjistruar

Kompania, 128.000 USD fitim më 2011

Nuk është zhvilluar asnjë lloj prokurimi

TIRANE

GENC KONDI

Zotëruesa e kompanisë "Emanuelle Adriatic Energy Ltd", që është "krahu" energjetik i izraelitëve të Israel Land Development, ka regjistruar shifra tepër të ultë biznesi gjatë vitit të kaluar, sikurse rezultojn nga raporti i auditit që është përgatitur në shkurt 2012. Qeveria shqiptare ka përzgjedhur një kompani, e cila gjatë gjithë vitit 2011 ka bërë vetëm 3 milionë dollarë shpenzime, të cilat, për kompanitë e naftës nuk janë asgjë. Në raport thuhet se kompania ka arritur të dalë nga humbja prej 1 milion dollarësh, e regjistruar në vitin 2010, por, gjatë 12 muajve të vitit të kaluar ka arritur të fitojë, si fitim neto, vetëm 128 mijë dollarë. Ndërkohë, edhe ecuria njëvjeçare e aksioneve të saj në bursa është negative. Vlera e tyre nga qershori 2011 deri në qershor 2012 ka shënuar një ulje në masën 43.09 për qind, sipas agjencisë Bloomberg. E gjithë shuma e përdorur për aktivitetin financiar gjatë njëviti të tërë ka qënë 200 mijë dollarë amerikanë, ndërkohë që më 2010 kjo shifër ka qënë 37 milionë USD. I gjithë kapaci-

teti i biznesit të firmës, duke përfshirë asetet, është 73 milionë USD, që e bën kompaninë Israel Land Development një ndër kompanitë më modeste në pellgun e Mesdheut që merren me naftë e gaz. Në fakt, ajo ka përvojë vetëm me dy puse në det, në perëndim të Izraelit, ku është në konsorcium me shumë kompani të tjera. Me performanca të tilla, duket e çuditshme pse qeveria

shqiptare të ketë zgjedhur pikërisht një subjekt të tillë si bashkëpunëtor, për t'i lënë në

dorë trajtimin e një pasurie të madhe nëntokësore, që mendohet se është nën Adriatik dhe që vlerësohet në miliarda dollarë.

Në fakt, sipas vendimit qeveritar, është kompania "Emanuelle Adriatic Energy Ltd.", e regjistruar në Qipro, filiale e kompanisë izraelite ILDC Energy, që mund të fillojë punën për kërkime dhe shfrytëzim të hidrokarbureve në një zonë të gjerë, prej 5,070 kilometrash katrore në detin

Year ended	For the period	
	From March 16, 2011 to December 31, 2011	From March 16, 2010 to December 31, 2010
Net income (loss)	128	(1,244)
Other comprehensive income		
Comprehensive income (loss)	128	(1,244)

Aktiviteti

Raporti i auditimit të veprimtarisë financiare të kompanisë-mërmë të "Emanuelle Adriatic Energy Ltd", ku theksohet se fitimi neto gjatë gjithë vitit 2011 ishte në kuotën e 128 mijë dollarëve amerikanë

Obligacionet

Letrat me vlerë, rekord interesi

Ka arritur në rekordin prej 10.85 përqindësh në vit interesi i letrave me vlerë të qeverisë. Kjo shifër është arritur në ankandin e së enjtes për shitjen e obligacioneve 7-vjeçare, që janë edhe letrat me vlerë me afatim më të gjatë. Obligacionet 5-vjeçare janë shitur deri tani me interes më të ulët se 10 përqindësh, ndërkohë që bonot me afat njëvjeçar maturimi kanë një normë interesi prej 7.38 për qind, nga 7.34 për qind, që ishin në ankandin e dy javëve më pare.

Adriatik, në zonën veriore. Kjo është bërë e mundur, pasi Vendimi i qeverisë nr. 383, që ishte miratuar më datë 6 qershor të këtij viti, përcaktohet se do të hynte në fuqi vetëm kur VKM-ja të publikohej në Fletoren Zyrtare, pa caktuar një datë fikse. Ky publikim është bërë më 13 qershor, në Fletoren e rradhës, duke zyrtarizuar lejen për kompaninë e huaj.

Kompania që zotërohet në 51% nga Israel Land Development Energy, nuk rezultojn të jetë e regjistruar, as në regjistrin tregtar shqiptar dhe as në atë të Republikës së Qipros. Kjo ka shtuar dyshimet se, pas këtij konkencioni, pa një garë të shpallur më parë, fshihen interesa pushtetarësh, ekonomike e politike. Gazeta ekonomike "Globes" shkruante pak ditë më parë se 49 për qind e aksioneve të "Emanuelle Adriatic" zotëroheshin nga shqiptarë, por ajo nuk specifikonte më tej, në se bëhet fjalë për Alpbetrolin, edhe ky në shtije, apo për persona privatë shiptarë apo subjekte vendase.

Ky subjekt ka deklaruar që vitin e kaluar se kishte arritur një marrëveshje të tillë me ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Por, vetëm në janar të këtij viti, sikurse njoftonte gazeta e specializuar ekonomike e Izraelit "Globes", ajo ka shpallur publikisht se një marrëveshje e tillë ishte premtuar përfundimisht nga pala shqiptare dhe pritej vetëm miratimi qeveritar që të zyrtarizohej.

Arkitekti IM stili në ambientet tuaja ...
 WWW.ARKITEKTI-IM.COM
 INFO@ARKITEKTI-IM.COM
 +355694012132/3



POLITIKE

Tirana bllokoi deklaratën e SEECP për shkak të Kosovës

Shqipëria ka bllokuar deklaratën e përbashkët në samitin e Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECP)...

samit, nuk e ka mbështetur tekstin, sepse, sipas tij, nuk ka qenë konstruktiv. "Këtë deklaratë nuk mund ta pranojmë..."

Tiranës se Kosovës duhet t'i mundësohet që të jetë anëtarë e barabartë e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore...

Anëtar i Komisionit parlamentar për Sigurinë: Ja fati i instucioneve Kushtetuese

PS, Lutaj: Pas Presidentit nga Berisha pritet gjithçka

Deputeti i PS: Nano s'përbën shqetësim, është në fatin e tij

Lajmi


Socialistët janë të bindur se Berisha pas zgjedhjes në krye të shtetit të një figure politike pa konsensusin e opozitës s'do të ndalet për asgjë...



Lëvizja Nano

"Nano s'përbën shqetësim, është në fatin e tij. Rama mirë ka thënë, ai ka ikur vetë, pasi i është turrur partisë për 7 vite me radhë..."

Në foto: Piro Lutaj



Prioritetet

PS, Dokle: Reforma parlamentare dështoi për shkak të mazhorancës

TIRANE

JAKIN MARENA

Socialistët parala jëmërojnë se nga kryeministri Sali Berisha tani e tutje mund të pritë gjithçka. Jo se kanë pasur ndonjëherë dyshime për këtë gjë...

TIRANE

Reforma parlamentare, megjithëse e rivendosur si kusht për marrjen e statusit të vendit kandidat në vjeshtë, mbetet e ngecur. Pasi ka rinisur puna për reformën...



reformën me përfundimin e mandatit të komisionit, madje firmosën dhe draftin që nuk mundi asnjëherë t'u përcillej deputetëve për miratim. Ndërsa për selinë rozë, kjo vijon të jetë një gëshhtë e hapur.

të s'është problem asgjë dhe nuk ndalet përballë asgjëje", tha Lutaj. Për të cilin tashmë s'është vështirë të parashikohet dhe si do të jetë fati i institucioneve kushtetuese...

zgjedhjen e drejtuesve të rinj të tyre. Kështu, është në përfundim mandati i Prokurorës së Përgjithshme Ina Rama, ka përfunduar mandati i 3 anëtarëve të Kushtetueses, të Gjykatës së Lartë dhe thembra e "Akilit" për Berishën...

SHISH, Bahri Shaqiri po i lëkundin pozitat. I pyetur në lidhje me faktin se sa vështirë do ta kenë punën institucionet Kushtetuese pas largimit të Topit, deputeti socialist shprehet se për Berishën s'ka asnjë vështirësi për asgjë.

pas zgjedhjes së presidentit të ri, s'ndalet para asgjëje. Tani Saliu përbën problem për ndërkombëtarët, të cilët e kanë të vështirë të pranojnë vënien nën kontroll të të gjithë institucioneve të pavarura, përbën problem për statusin e vendit kandidat për në BE, ku për fat të keq gjasat janë të dështojmë për herë të tretë. Pra në mendjen e tij ai s'ka vështirësi për asgjë pas zgjedhjes së Presidentit të ri", tha Lutaj. Ai flet dhe për qëndrimin e PS pas këtyre zhvillimeve. "PS është në aksionet e veta politike në funksion të konsolidimit të strukturave dhe të kontakteve me elektoratit. S'kanë të bëjnë veprimet tona asgjë më me Saliun", tha Lutaj. Njëherësh tek shprehet për organizimin e PS në bazë, deputeti Lutaj s'refuzon të flasë dhe për lëvizjen e ish-kreut të PS. "Fatos Nano s'është gjarpër që ha njerëz, por kur dëgjon që Majlinda Keta flet për Nanon vërtetë të vjen keq. Kur po e dëgjoja, i jam larguar Nanos një hap më shumë. S'ndiqet pas një njeri që ka ndihmuar 7 vjet Berishën, siç ka bërë Nano në këto vite", tha deputeti Lutaj. Por sërish ai shprehet se Nano s'është ndonjë problem për PS. "Nga pikëpamja personale ka një ndjesi jo pozitive për të folur për të. Më e mira do të ishte ta linim në fatin e vet, por kur ai thotë gjëra të paimagjinueshme s'ri dot pa folur. Nano s'përbën shqetësim, është në fatin e tij. Rama mirë ka thënë, ai ka ikur vetë, pasi i është turrur partisë për 7 vite me radhë, duke kërkuar vetëm 3 ditë para zgjedhjeve që të mos votohej për PS", tha Lutaj.

Berisha:

"Vendorët të mbledhin taksat"



Kryeministri Berisha s'refuzon të flasë dhe për lëvizjen e ish-kreut të PS. "Fatos Nano s'është gjarpër që ha njerëz, por kur dëgjon që Majlinda Keta flet për Nanon vërtetë të vjen keq. Kur po e dëgjoja, i jam larguar Nanos një hap më shumë. S'ndiqet pas një njeri që ka ndihmuar 7 vjet Berishën, siç ka bërë Nano në këto vite", tha deputeti Lutaj. Por sërish ai shprehet se Nano s'është ndonjë problem për PS. "Nga pikëpamja personale ka një ndjesi jo pozitive për të folur për të. Më e mira do të ishte ta linim në fatin e vet, por kur ai thotë gjëra të paimagjinueshme s'ri dot pa folur. Nano s'përbën shqetësim, është në fatin e tij. Rama mirë ka thënë, ai ka ikur vetë, pasi i është turrur partisë për 7 vite me radhë, duke kërkuar vetëm 3 ditë para zgjedhjeve që të mos votohej për PS", tha Lutaj.



POLITIKE

KQZ të mos hapë kutitë, Gjata: Ankimet në gjykatë

Ekspertët zgjedhorë e shohin zgjidhjen e problemit të ankimeve e rinumërimin e votave te Kolegji, duke përjashtuar KQZ nga ky proces. Çlirim Gjata thotë se nuk duhet të jetë KQZ ai që të vendosë për ankimet dhe rihapjen e kutive, por gjykata. "Të ndryshohet sistemi i konceptit të punës në këtë institucion. Nga një institucion që i pranon ankimet e gjithë kjo është

thembra e "akilit", të kthehet në një institucion administrativ i cili merret vetëm me përgatitjen e bazës materiale, shpërndarjen e saj, përgatitje të zgjedhjet e kaq. Gjithçka tjetër të kalojë në Gjykatë. Edhe rezultati kur ankimohet, dhe pavarshmëria, nga KZAZ të ankohet direkt te gjykata i cili kërkon pastaj një sistem të ri të administrimit gjyqësor për zgjedhjet", tha Gjata, ish-kreu i KQZ. Ai

thotë se krijimi i 6 kolegjeve do bëjë të mundur shqyrtimin e çështjeve e nxjerrjen e fituesit të zgjedhjeve në kohë reale. "Nëse shkoni në gjykatë mbaron shpejt, por një sistem i ri i administrimit gjyqësor, për çështjet zgjedhore, jo ky që është me një kolegj. Mund të ndahet të bëhet me 6 kolegje. Një kolegj për dy qarqe për shembull. Ky siç është por me disa gjykata", thotë Gjata.

U largua nga puna SMS-ja për Berishën nga themeluesi i PD

■ ■ ■ **TIRANE**

Një SMS e kapur në telefonin e Kryeministrit gjatë seancës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës nga një numër tjetër telefonik fliste qartë për një ankesë gjithë revoltë të dërguesit. Në përpjekje për të zbuluar dërguesin dhe për të bërë public shqetësimin e tij Shqiptarja.com kontaktoi numrin dhe personi që u përgjigj nga ana tjetër duke ruajtur me fanatizëm identitetin tha se ishte nga Vlora, madje një antar i Partisë Demokratike. "Nuk ka rëndësi emri im mund t'u them se pasi kam dërguar dhjetra letra kryeministrit dhe nuk mora përgjigje, nisa të dërgoj mesazhe telefonike në drejtim të tij. Nuk kam probleme pronash por vetëm një problem me punësimin tim. Kam qenë punonjës i Prefekturës së Vlorës



Një SMS e dërguar në telefonin e Kryeministrit gjatë seancës për zgjedhjen e Presidentit

dhe jam shkarkuar në kundërshtim me të gjitha ligjet nga njerëz të korruptuar. Ky ka qenë shqetësimi im,

prandaj kam këmbëru dhe sms me kryeministrit", - është shprehur personi nga ana tjetër e telefonit. Në tentativë për të siguruar identitetin e tij dhe një intervistë qytetari nga Vlora është shprehur se nuk dëshiron t'i bëjë publik emri dhe se të gjitha të dhënat për të i dinte shumë mirë kryeministri i vendit. Me pas nëpërmjet një sms-je dërguar gazetës ai ka shkruar se: "Unë ja kam dërguar Berishës disa sms për ato çka mendoj. Unë kam shumë miq gazetarë, por kam zgjedhur ti drejtohem direkt atij si kryeministrit për çështjet në fjalë. Unë jam themelues i degës së PD-së së Vlorës. Sms-të ja kam dërguar Berishës edhe si kryetar i PD-së. Unë kam besim te institucioni i kryeministrit dhe ruaj besimin se do marr prej tij një përgjigje institucionale. Nëse do e gjej të nevojshme do kontaktoj vetë me ju. Faleminderit".



Zbardhen prapaskenat, si hoqi dorë kryeparlamentarja nga kandidimi për kryetare e shtetit

Presidenti, pse u "rrëzua" Topalli

Nënkryetarja e PD ishte kandidaturë e parë e Berishës për t'u zgjedhur, por pasiguria e mbështetjes solli kalimin tek Imami, që dhe ai u rrëzua, për të kandiduar Nishanin, si njeriun që i bashkonte të gjithë

■ ■ ■ **TIRANE**

JAKIN MARENA

Berisha ka hequr dorë nga kandidatura e kryetares së Kuvendit, njëherësh nënkryetare e PD për ta futur në garë si Presidente të Republikës jo për shkak të dëshirës së tij për të pasur një president konsensual, pasi atë se kishte në mendje që në fillim, pavarësisht kandidatëve jopolitike që hodhi në treg. Shkaku i vërtetë ka qenë se informacioni i fundit që kishte mbërritur në tavolinën e kryetarit të mazhorancës ishte se 1/4 e deputetëve të mazhorancës, pra aleatë plus deputetë të PD, nuk do të votonin kandidaturën e Topallit, duke e rrëzuar atë në raundin e katërt. Dhe nuk do të ishte thjeshtë një rrëzim kandidature, por nga ana psikologjike dhe



rënie të mazhorancës, për shkak se nuk votohej nënkryetarja e partisë më të madhe të koalicionit qeverisës të PD. Burime të besueshme brenda selisë blu por dhe grupit parlamentar të PD bëjnë me dije

se aleatët si pikë e parë ishin kundër kandidaturës së Topallit. Por nëse do të ishin vetëm votat e aleatëve, atëherë Topalli kandidohej, pasi plotësoheshin 71 votat. Por kishte shumë deputetë të

Berisha:

"Topalli, përfaqësuesja më dinjitoze për kryetare shteti"

A nuk kërkoi kryetari juaj, tre muaj rresht, që të mos jetë zonja Jozefina Topalli, e cila në vetëdijen time më të thellë përfaqëson dhe do ta përfaqësojë këtë vend në mënyrën më dinjitoze. Në këtë proces u ngrita mbi veten time, u ngrita mbi bindjet e mia se njeriu që do ta përfaqësojë vendin në mënyrën më dinjitoze do të ishte zonja Topalli", ka qenë deklarata e Berishës në mes të Kuvendit. Duke nënvizuar se për të zgjedhur një president konsensual ai ishte ngritur mbi bindjet e tij.

PD, që për shumë arsye, për shkak dhe të përplasjeve dhe klaneve brenda kësaj partie, nuk e mendonin një votë pro Topallit. Madje dhe sikur të shkonin në zgjedhje të parakohëshme, do votonin kundër

saj, vetëm e vetëm që Topalli të ngarkohej me përgjegjësi dhe gjithë kuotat e saj politike të binin. Që Topalli preferohej nga Berisha që kishte dhe vullnetin ta votonte për Presidentin e vertetojnë deklaratat

e tija vlerësuese për kryetaren e Kuvendit, por dhe fakti që në fund të herës Berisha kandidat politik votoi për President, dhe justifikimi se hoqi Topallin për konsensusin nuk pinte më ujë. Por duke qenë se votat për Topallin ishin në rrezik, dhe mund të rrezohej si kandidatë, Berisha preferoi si kandidaturë të dytë për President ministrin e Mbrojtjes, Arben Imami. Duke tentuar të merrte mbështetje dhe nga PS pasi ka qenë ministër në disa kabinete qeverisëse të PS, kandidaturë dhe arsye që u pranua publikisht dhe nga kreu i LSI, Ilir Meta. Por dhe kjo kandidaturë ka rënë, pasi grupi i qëndrestarëve të PD nuk e votonte "Gjeneralin e vitit '97". Në këtë mënyrë Berisha ka gjetur të vetmen figurë që mbështetej nga të gjitha palët, Bujar Nishanin, që nuk sulmohej nga ana opozita.

PELOD STUHLING ORIGINAL
Marke Amerikane (New York), garancia 2 vjet
 Adresat: Dytani Kleopatra perballë kompleksit Taiwan Flagship Center Durrës
 cel: +355 696235070
 albaniatime@gmail.com

Crystalblue
 sustainable water technologies
Grup Zjarrfikseje
Pompa
Gjeneratore
Pishina
Përpunim uji
 Adresa: Unaza e Re, pranë Alpha Bank Tiranë;
 Tel/fax: +355 4 8320162;
 Mob: +355 69 400 95 87
 E-mail: erjon@crystal-blue.gr

Higjenë e garantuar nga
ALPEN PULITO
 Firme Pastrimi, Shërbime speciale pastrimi, Pastrim dyshemeje te çdo lloj siperfaqeje, Produkte pastrimi, Shërbime DDD
 Cel 0682009101 ose 0683055364
 info@alpenpulito.al - www.alpenpulito.al
 Dezinsektim
 Deratizim
 Dezinsektim
 Makineri paisje-aksesore pastrimi, Auto vinc me qera



POLITIKE

Tavo: LSI, forca politike që mbrojnë interesat e emigrantëve

Deputeti i LSI për Qarkun Gjirokastrë, Vangjel Tavo, ka kryer ditën e fundit një sërë takimesh me emigrantë dhe simpatizantë të LSI, për të dëgjuar nga afër problemet e tyre duke i njohur ato me programin e LSI për emigracionin. Në një takim i organizuar në qytetin e Elasona, Tavo tha se emigrantët shqiptarë janë promotorë të rëndësishëm të integritimit të vendit. Sipas tij emigrantët shqiptarë në

shtetin grek janë kontribues serioz në ekonominë e dy vendeve, atë shqiptare dhe ekonominë greke. Tavo, u shpreh se qeveria shqiptare i ka kushtuar rëndësi shumë të madhe dhe ka treguar interes për emigrantët, sidomos në krijimin e mundësive për mësimin e gjuhës amtare. Sipas tij një nga objektivat e LSI është që të mundësojë krijimin e lehtësirave fiskale për të gjithë emigrantët shqiptarë që duan

të investojnë në Atdhe. Tavo tha se LSI ka treguar dhe vazhdon të tregojë që është forca politike e cila mbrojnë investon për interesat e emigrantëve. Tavo, ka diskutuar me të pranishmit gjithashtu propozimin e tij për ngritjen e një zyre këshillimi pranë zyrave të LSI në çdo qytet të Shqipërisë për të këshilluar emigrantët që riatdhesohen dhe duan të hapin një aktivitet në Shqipëri.

Presidenti i Komisionit Evropian uron Presidentin: Kujdes me institucionet e pavarura

Barroso-Nishanit: Moment kritik

Kreu i KE: Reformat integruese kërkojnë një konsensus të gjërë kombëtar. Siguroni klimë paqësore e te qëndrueshme politike e pavarësinë e profesionalizmin e institucioneve kyçe, veçanërisht në fushën e gjyqësorit

TIRANE

Lajmi

JAKIN MARENA


Kreu i KE Barroso përmes një mesazhi urimi i kërkon Presidentit Nishani që të jetë mbi palët dhe të luajë rolin që i takon në garantimin e pavarësisë së institucioneve. Barroso e quan moment kyç këtë që po kalon Shqipëria dhe kërkon të finalizohet marrëveshja e nëntorit për reformat

Presidenti i Komisionit Evropian, Jose Manuel Barroso, ndërsa ka uruar Presidentin e ri Bujar Nishani për zgjedhjen në këtë post, ka risjellë dhe njëherë në vëmendje të politikës shqiptare nevojën për bashkëpunim dhe implementim të plotë të marrëveshjes së nëntorit. Në mesazhin e plotë të zyrtarit më të lartë të Komisionit Evropian citohet qartë dhe pre-re se vendi duhet të përmbushë reformat e nevojshme për integritet dhe se kryerja e plotë e kë-

tyre reformave kanë nevojë për një konsensus kombëtar.

"Ky është një moment kritik për rrugën evropiane të Shqipërisë", nis mesazhin e tij kreu i KE. Barroso vlerëson rolin e kreu të shtetit si shumë të rëndësishëm në zbutjen e klimës politike në vend. "Do të doja t'u

përgëzoja për zgjedhjen tuaj si President i Republikës së Shqipërisë. Ky është një moment kyç në rrugën evropiane të Shqipërisë. Reformat që duhet të ndërmarë Shqipëria për të bërë përpara drejt BE kërkojnë një konsensus kombëtar e një punë të vazhdueshme, koherente e



Faksimile e letrës së Barrosos për Nishanin

konstruktive nga të gjitha institucionet e partitë politike", shkruan Barroso. "Si President, teksa përfaqësoni unitetin kombëtar të popullit në të njëjtën

linjë me Kushtetutën, ju do luani një rol jetësor për të siguruar një klimë paqësore politike të qëndrueshme si dhe në luftën për pavarësinë dhe profesional-

izmin e institucioneve kyçe, veçanërisht në fushën e gjyqësorit", shpreh Barroso. Teksa thotë se "Bashkëpunimi i ngushtë dhe i sinjertë mes forcave politike, sidomos në finalizimin i zbatimit të marrëveshjes së nëntorit mes partive politike, si dhe angazhimi i vazhdueshëm dhe me përgjegjshmëri, por edhe vendimet pragmatike nga ana e palëve të interesuara janë baza për të bërë që reformat e kërkuara të vihen në zbatim". Ai uron sukses në misionin e tij për të ndihmuar Shqipërinë që të përmbledhë forcat që të përballen me sfidat në rrugëtimin e saj drejt të ardhmes së saj evropiane.

Koment

Në Rio për të zgjedhur të ardhmen



NGAJANE POTOČNIK*

vijon nga faqja 1

...në një ekonomi të gjelbër motivohet nga investime të cilat reduktojnë presionin ndaj mjedisit dhe shërbimeve ndaj ndesh, duke theksuar eficientë e energjisë dhe burimeve. E thënë më thjeshtë, sipas një diplomati Afrikan: është strategjia jonë e mbijetesës. Ekonomia e gjelbër është një mjet drejt zhvillimit të qëndrueshëm pa barazi sociale; nuk mund të ketë zhvillim pa menaxhimin e duhur të burimeve tona natyrore tek të cilat varen ekonomitë tona. Ne kemi nevojë për zhvillim të qëndrueshëm për të arritur prosperitet për shumë njerëz sesa fatkeqësi për të gjithë.

Ne kemi patur disa progres që prej vitit 1992, por natyrisht nuk ka qenë i mjaftueshëm. Miliona njerëz vuajnë ende sot nga uria. Nëse vazhdojmë të përdorim burimet në shkallën aktuale, në vitin 2050 do të kemi nevojë për ekuivalentin e më shumë se dy planeteve për të na mbajtur, dhe aspiratat e shumë njerëzve për një cilësi më të mirë jetese nuk do të arrihen.

Më të varfërit në shoqëritë tona do të vuajnë më shumë nëse i përdorin burimet tona në mënyrë të paqëndrueshme pasi jetët dhe jetesa e tyre varen drejtpërdrejt nga uji, toka, deti, pyjet dhe dheu. Ekzistojnë sfida të reja të cilat përbëjnë kërcënime serioz ndaj zhvillimit të qëndrueshëm – që nga ndryshimet klimatike dhe mungesës së ujit deri tek fatkeqësitë natyrore dhe humbjet e biodiversitetit dhe ekosistemit.

Megjithatë, ne kemi instrumentat për të ballafaquar këto sfida dhe për t'i transformuar ato në mundësi. Shumë vende mund të kalojnë shpejt drejt teknologjive efiente dhe sistemeve të cilat do t'i mundësojnë ato të shfrytëzojnë burimet e tyre, që nga pyjet dhe biodiversiteti deri të toka dhe mineralet, në mënyra të cilat janë të qëndrueshme dhe mundësojnë mbështetjen e rritjes së kon-

sumit. Vendet në zhillim mund të kenë rreth 70 deri 85% të mundësive për të rritur produktivitetin e burimeve. Vende të cilat mësojnë të shfrytëzojnë kapitalin e tyre natyror në një mënyrë inteligjente të qëndrueshme do të jenë fitimtarë e së nesërme. Sipas një raporti të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, transformimi drejt një ekonomie të gjelbër mund të gënjerojë 15 deri 60 milionë punë të tjera në të gjithë botën gjatë dy dekadave të tjera si dhe do të nxjerrë nga varfëria me qindra e mijëra punëtorë.

Kjo është arsyeja se pse Bashkimi Evropian do të vazhdojë të luftojë që Rio 20+ të dalë në një përfundim të fokusuar dhe ambicioz. Ne duam që të fillojmë diçka të pakthyeshme, diçka që ka ndikim real në jetët e njerëzve. Në fund të fundit, kjo është një konferencë për njerëzit – për ne, për të ardhmen tonë. Ne kemi sugjeruar qëllime dhe objektiva mbi burimet kryesore natyrore që mbështesin një ekonomi të gjelbër: uji, oqeanet, toka dhe ekosistemet, pyjet, energji të rriciklueshme dhe eficientë burimesh përfshirë mbetjet. Këto objektiva janë thelbësore për një rritje të qëndrueshme dhe të lidhura ngushtë me qëshitet e sigurisë së ushqimit, uljen e

varfërisë dhe zhvillimin social. Këto qëllime do të bëjnë sektorin privat të investonte, do të nxisin risi teknologjike dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Një nga rezultatet e dëshiruara të Rios është se të gjitha kompanitë e mëdha private të renditura në bursat botërore duhet të përfshijnë në raportet e tyre vjetore rriciklimin, ose në të kundërt të shpjegojnë pse nuk e bëjnë një gjë të tillë. Banka Botërore ka lanqar një iniciativë interesante, ku kompanitë do të përdorin mekanizma kontabël në statistikat e tyre. Ky mund të jetë fillimi i një realiteti të ri, ku kapitali natyror dhe rriciklueshmëria ka vlerë. Por është e qartë se ndryshimi nuk do të ndodhë pa angazhimin e të gjithëve. Jo vetëm politikanët do të duhet të binden – gjithashtu kemi nevojë edhe për përfshirjen e bizneseve, shoqërive civile dhe individëve.

Ndërsa shumë vende kanë një strukturë më të mirë sot në krahasim me njëzet vjet më parë, më të varfëre do t'u nevojitet ende ndihmë për të patur akses në edukimin, infrastrukturën dhe aftësitë e duhura. Kjo është arsyeja pse BE-ja mbetet donatori më i madh i ndihmave në botë. Në vitin 2011 dhamë 53 miliardë euro në ndihmë të zhvillimit – më shumë se gjysma e ndihmave në të

gjithë botën. Dhe kjo është arsyeja se pse ne do t'i mbajmë premtimet tona. Pavarësisht krizës financiare aktuale, vendet e BE-së kohët e fundit rrafmuan këtë zotim, i cili do të shëndërrohet në një ndihmë shtesë të rëndësishme për zhvillimin deri në vitin 2015, përfshirë projektet e lidhura me rezultatet e Rios.

Atëhere lind pyetja: çfarë të ardhme duam? Ja përgjigjia nga 17-vjeçarja Britania Trillford (Brittany Trillford) nga Zelanda e Re, fituesja e konkursit "E Ardhmja që Duam" dhe që do të drejtojë udhëheqësit në Rio: "Sinjorë, unë do të isha e lumtur vetëm të kisha një të ardhme. Ta kisha të garantuar. Nuk e kam këtë tani." Kjo nuk duhet vetëm për të ardhmen e brezit të Britanisë dhe të brezave të ardhshëm. Kjo tashmë është për ne, është e ardhmja jonë të cilën ne e vëmë në rezik nëse nuk i zgjidhim problemet e burimeve që nuk janë të pafundme, problemet e zhvillimit të paqëndrueshëm dhe problemet e varfërisë masive. Le të mos e humbasim mundësinë që kemi për të zgjedhur të ardhmen që duam – ndërsa ende kemi mundësi ta bëjmë këtë.

*Autori është Komisioneri i BE-së për Mjedisin

Advertisement for security cameras and DVRs. Includes text: 'OFERTA 499 € KITI', 'Me Gjithçka përfshirë', and 'Monitori sipas preferencës'.

Advertisement for IMPACT electronic & professional. Includes text: 'Bëni pushime të gëra', 'Tel/Fax: 04 2269 049', 'www.impact-al.com'.

Advertisement for security cameras and DVRs. Includes text: 'OFERTA 555 € KITI', 'Me Gjithçka përfshirë', and 'Monitori sipas preferencës'.



Shkodër, Inspektori i pyjores, shoqërues i kamionëve kontrabandë

Një inspektor pyjesh ka rënë në prangat e policisë pasi akuzohet për shpërdorim detyre. Personi i arrestuar është Gjon Mark Nika, 35-vjeç, banues fshati Dobrac komuna Rrethina në Shkodër. Nika u kap në flagrancë në orën 23.30, duke shoqëruar shtetasin Lavdrim Kullaj me automjetin e tij, kamion i markës "Mercedes Benz" me targë SH 9929 D, të ngarkuar me lëndë drusore. Lëndë drusore

rezulton se është prerë në mënyrë të paligjshme në zonën ku Nika kishte për detyrë ta ruante. Ndaj inspektorit të policisë pyjore ka nisur hetimi. Veprat Penale kundër mjedisit janë dyfishuar gjatë vitit 2012, por nga ana tjetër është ulur numri i personave të pandehur për këto vepra penale. Sipas analizës së Prokurorisë, në të gjithë vendin rezultoi se në këtë grup veprash penale, ku përfshihen

ndotja e ajrit, e ujit, peshkimi i ndaluar, shkatërrimi me zjarr i pyjeve, etj. Peshën kryesore e zë prejra e paligjshme e pyjeve, për të cilën janë konstatuar 172 raste në të gjithë Shqipërinë me 108 të pandehur. Qarqet me problematike ku konstatohet një rritje kritike e prerjes se paligjshme të pyjeve janë Elbasani me 56 raste, Korça me 32 raste, Pogradeci me 16 raste, si dhe Dibra me 13 raste.

I vodhën Laptopin dhe pistoletën "Beretta"
Grabitet banesa e trupprojës së Ina Ramës
 Policia dyshon për një vjedhje të planifikuar

TIRANE

HABJON HASANI

Lajmi

Vidhen laptopi personal, pistoletë e shërbimit tip "Beretta" si dhe disa bizhuteri. Vjedhja ka ndodhur gjatë orëve të mbrëmjes së ditës së enjte. Dyshohet se hajdutët kanë planifikuar dhe kanë mbajtur nën vërtetë shtëpinë e Marije Ramajt por policia ende nuk ka identifikuar autorët e kësaj ngjarjeje.

Grabitet banesa e trupprojës së kryeprokurores Ina Rama. Policia bën me dije se kanë qënë dy autorë ata që kanë grabitur banesën e gardistes Marija Rama që përgjigjet për sigurinë e kryeprokurores. Policia dyshon se mund të jenë dy grabitës ata që kanë hyrë brenda në banesën e trupprojës së Ina Ramës. Autorët kanë arritur të vjedhin një lap-top si dhe armën personale të saj. Policia bën me dije se grabitësit kanë arritur të marrin armën e shërbimit, një pistoletë tip "Beretta", lëshuar nga Garda e

Republikës. Banesa e Marija Ramës ndodhet pranë rrugës "Siri Kodra" në Tiranë, ajo është një shtëpi prdhese dhe autorët dyshohet se kanë hyrë nga dritaret e banesës. Burime nga policia e Tiranës thanë dje se banesa mendohet të jetë grabitur rreth intervalit kohor 20:00-23:00 të ditës së enjte kohë kur Marija Ramaj dhe familjarët e saj nuk kanë qënë në shtëpi. Pas kthimit

në shtëpi rreth orës 23:30 Ramaj ka konstatuar grabitjen dhe ka njoftuar menjëherë policinë. Ekspertë të policisë shkencore kanë ekzaminuar shtëpinë në kërkim të gjurmëve të gishtave të grabitësve po pa mundur të dokumentonin ndonjë provë. "Nuk janë mundur të mblidhen shenja gishtërinjsh dhe hajdutët duket se kanë punuar me kujdes"- tha dje një agjent

policor i zonës. Nga ana tjetër trupprojëja e kryeprokurores ka deklaruar për policinë se është hera e parë që vjedhin shtëpinë e saj dhe se në kompjuterin personal të vjedhur ajo ka mbajtur vetëm materiale të parëndësishme. I vetmi send i vjedhur i cili paraqet rrezikshmëri tashmë është pistoletë tip "Beretta" të cilën hajdutët e kanë gjetur pasi kanë bastisur një prej komodinave të shtëpisë. Nga ana e saj policia ka shoqëruar dje disa persona me precedentë për vjedhje në zonën e rrugës "Siri Kodra" pasi mendon se hajdutët kanë patur informacion dhe kanë vjetruar lëvizjet e banorëve të shtëpisë përpara se të hyjnë dhe të vidhin. Katër muaj më parë në



Në foto: Ina Rama me dy trupprojat e saj

Tiranë u grabit dhe shtëpia e ministrit Spiro Ksera. Policia në këtë rast mundi të arrestonte autorin dhe më pas zbuloi se vjedhja e banesës së ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Spiro Ksera nuk ka qënë një rastësi, por grabitësit kishin piketuar prej kohësh pikërisht zyrtarin e lartë shtetëror me pretendi-

min se ai duhet të ishte i pasur. Përveç ministrit Ksera, e njëjta bandë hajdutësh ka grabitur edhe banesat e pesë biznesmenëve të rëndësishëm në kryeqytet duke u larguar prej tyre me sende me vlerë. Sipas hetuesve të çështjes, grabitësit dinin në të gjitha rastet se e kujt njeriu ishte shtëpia që do thyhej.



EDITORIAL

NGA ARBEN KROZHANI

Kalaja e pamposhtur e qeverisë

vijon nga faja 1

...ndalojnë shtetas dhe vetëm kaq. Pjesa tjetër qeverisë është në duart e lazaratasve, që prej gati dy dekadash këtë punë kanë bërë, duke u vetëqeverisur, duke mos pyetur as për ligje, as për shtet.

Dhe kanë punuar shumë. Gati çdo ditë do të ketë ngarkesa me drogë të presuar ose jo që kapet nëpër Shqipërisë, ose në daljet kufitare dhe që ka origjinën nga Lazarati. Shpeshherë policia ka bllokuar autobotet me ujë për të mos u futur në fshat.

Dhe fshati lulëzon: siç na e tregoi dokumentari i dy të rinjve holandezë që hipur mbi dy motorcikleta që hynë në fshat, bënë edhe filmime, provuan edhe mallin dhe ikën, duke u treguar mbarë botës, se çfarë ndodhte në këtë pjesë Shqipërie, që është jashtë juridiksionit qeverisës. Në Tiranë ka patur polemika dhe përplasje pse nuk arrin qeveria ta "nënshtrrojë" këtë fshat, ta heqë nga njolla e errët e hartës botërore të lëndëve narkotike, pse drejtori i policisë duhet të hyjë në fshat dhe të kërkojë me përlujë që të mos rritet më drogë, ndërsa në Tiranë e kudo drejtësia dënon edhe përdorues që kapen me 2 gramë bar.

Nuk ka dyshim se qeveria e kryeministrit Sali Berisha, arrin të marrë qdo kala. Të paktën prej vitit 2005, nuk ka lënë të tillë pa pushtuar. Ka marrë institucionet e pavarura kushtetuese, gjyqësorin, mori së fundmi presidencën, është në rrugë e sipër për të marrë Prokurorinë, SHISH-in. Do të jetë në luftë derisa të marrë edhe kalanë e opozitës. Pra kur do qeveria e kap "lepurin me qerre". Vetëm Lazaratin jo. Për të treguar se e do si plaçkë të veten, siç rrahin gjoksin se është bastion i PD-së? Apo për të nxjerrë përfitime nga sasitë kolosale që prodhon kjo kala narkotike?

Pyetje që i bëhen ish-ministrit të brendshëm, Bujar Nishani, tashmë president i votuar dhe mbarë zinxhirit drejtues, deri të kupola qeverisëse.

Gjyqi për akuzat

Fëmijët e Berishës duan 8 milionë nga Tahiri, reagimi: Kam dokumente të tjera

TIRANE

Pas 12 seancave gjyqësore avokati mbrojtës i dy fëmijëve të kryeministrit Berisha, Sokol Barçi ka dhënë konkluzionet përfundimtare ndaj deputetit socialist Sajmir Tahiri. Ai i kërkoi gjykatës të detyrojë të paditurin prej tyre, deputetin Tahiri t'i shpërblejë dy fëmijët e kryeministrit Berisha për dëmin pasuror dhe jo pasuror me nga 4 milionë lekë secilin. Deputeti Tahiri kërkoi kohë që të jepte konkluzionet e tij, përpara se gjykatesi Ilir Çeliku të shpallë vendimin. Gjykata i dha kohë deri më 20 qershor. Tahiri tha për mediat se ka dokumentet e duhura për të provuar qendrimin e tij në një emision ku ai pohonte se fëmijët e kryeministrit janë të korruptuar. "Unë



kërkova të rihapet procesi gjyqësor për-sa kohë kam prova ende, mbi bazën e të cilave kam bindjen dhe perceptimin tim se fëmijët e kryeministrit janë të korrup-

tuar. Bazuar në deklaratat e pasurisë së fëmijëve të kryeministrit; Shkëlzen Berisha në vitin 2006 ka patur pasuri 9 mln lekë të vjetra, në vitin 2011, 630 mln lekë të vjetra, Argita Berisha Berisha ka deklaruar në vitin 2006 880 mln lekë të vjetra, në vitin 2011, 1 mld e 820 mln lekë të vjetra. Pra ky kapërcim fantastik pasurisë, i pajustificuar, vetëm me faktin që punon në zyrën e avokatisë Argita e Shkëlzeni si sekser tokash, mua nuk më bind. Për këtë arsye i thirra në gjykatë të vinin të provonin pasurinë e tyre. Gjykata s'më lejon, por unë kam këto dhe prova të tjera që tregojnë se pse ata janë të përfshirë në afëra korruptive që formalizohen në këtë pasuri të deklaruar dhe në shumë të tjera të padeklaruar", deklaroi deputeti Tahiri.

FISIOMED OFRON SHERBIME FIZIOTERAPIE PROFESIONALE NE NJE AMBIENT KOMOD DHE MODERN. EKSPERIENCA PERENDIMORE DHE APARATURAT E GJENERATES SE FUNDIT JANE TASHME PRANE JUSH. BESOJANI SHENDETIN TUAJ FIZIOTERAPISE PROFESIONALE



Adresa: Rruga e Barrikadave 19/2, Galeria e Tiranës Ish Kinema 17 Nentori, Kat 3
 Tel: +355 42 400 418 / Cel: +355 69 20 533 30;
 E-mail: info@fisiomedal.com / Web: www.fisiomedal.com

- Hernie diskale
- Paralizat e ndryshme
- Spondilozat
- Marjje mendsh
- Bursitin
- Enjten e krahut
- Tendinitin
- Dhimbjen e nofules
- Skoliozen
- Celullitin
- Traumat e gjurit
- Para dhe mbas lindjes



Abonohu!

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:
To Subscribe please contact:

Agjencia e Abonimeve të Shtypit (TRENOVA)

Mobile: +355 682047825

e-mail: arbtrenova@yahoo.com

POSTA SHQIPTARE

Telefon: +355 4 2375598

e-mail: abonime@postashqiptare.al

ADRION Ltd

Telefon: +355 4 2240018

e-mail: sales@adrionltd.com



[SHQIPTARJA.com]

origjina e lajmit...



Ministri i Arsimit Tafaj, gjobitet me 500 mijë lekë

Gjobitet me 500 mijë lekë të vjetra Ministri i Arsimit dhe Shkencës Myqerem Tafaj. Vendimi për gjobitjen e tij është marrë nga zyra e përbarimit "Albance.Sh.p.k" që drejtohet nga përbaruesi Bafraj Nela. Mësohet se gjobitja e ministrit është bërë për shkak se ai nuk ka pranuar të bëjë ekzekutimin e vendimit gjyqësor, për rikthimin në punë të një nga punonjëset të

shkarkuar pak kohë më parë nga ministri. Disa herë më rradhë ministri ka neglizhuar veprimet e përbaruesit Bafraj Nela, duke e detyruar këtë të fundit që të vendosë një gjobë prej 500 mijë lekë të vjetra në ngarkim të Myqerem Tafaj. Kaq ka mjaftuar që ky i fundit të reagojë duke paditur civilisht në Gjykatën e Tiranës zyrën përbarimore "Albance.Sh.p.k". Padia është rregjistruar dhe në sekretarinë e

gjykatës, ndërkohë që gjyqtarja që do e gjykojë këtë çështje është caktuar Rezarta Balliu. Në objekt padinë e ngritur nga kreu i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës kërkohet kundërshtim i vendimit të shoqërisë përbarimore private "Albance shpk" përbaruesit gjyqësor privat Bafraj Nela për vendosjen e gjobës prej 50.000 lekë ndaj Myqerem Tafaj.

Përbaruesi premtonte në emër të djalit të Berishës

"Miku" i Shkëlzenit keqtrajton klientin

Florian Beqaraj rrahu në zyrë Kodhelaj

Lajmi

Një përbarues privat arrinte të mashtronte klientët e tij, duke ju prezantuar si mik i ngushtë i Shkëlzen Berishës, djalit të kryeministrit Sali Berisha si dhe disa deputetëve të tjerë. Florian Beqaraj, jo vetëm që ka përdorur këto taktika mashtrimi por në fakt ka keqtrajtuar klientin e tij, duke i thyer dhe hundën.

moment ka ndërhyrë e fejuara e tij, shtetësja Alma Muda

Gjakmarrja

Shoqëria civile: Ndaloni vrasjet

Sherri për një vijë uji për Svaditje në Malësinë e Dukagjinit i ka kushtuar jetën tre personave, mestë cilëve edhe një vajze vetëm 17 vjeç. Marie Qukaj mbeti e vranë në vend me armë zjarri, ndërsa ishte duke vaditur parcelat me misër pranë banesës së saj, së bashku me gjyshin 70 vjeç. Kole Qukaj, humbi jetën më pas në spital. Autorët e kësaj ngjarje janë banorë të lagjes "Skënderbej" në Shkodër dhe janë vendosur aty së fundmi. Dy familjet Prroi dhe Qukaj jetonin dikur në fshatin Kir të komunës Pult pranë njera-tjetres deri sa nisi edhe gjakmarrja. Pas këtij krimi të rëndë, organizata Forumi i Mendimit të Lirë, ka deklaruar se vrasësi i vërtetë nuk është gjaksi që fshihet pas shkurreve si burracak dhe vret fëmijët, por shteti që vazhdon të mbyllë sy e veshe përballë kësaj maskarade, e cila nuk mund dhe nuk duhet lejuar të na shoqërojë rrugës për në Bashkimin Europian.

e cila tentoi të lajmërojë Policinë e Shtetit për incidentin. Mirëpo teksa ajo tentonte me telefon për të lajmëruar efektivët e policisë, përbaruesi Florian Beqaraj si një drejtues bande kriminale ka marrë telefonin duke pohuar se do lajmëronte ai policinë. "Alo, policia hajdeni urgjent se kemi një incident"-kjo ishte fjalia e tij dhe sipas Kodhelaj pas 5 minuta ka mbëritur një automjet me ngjyrë të bardhë nga ku kanë zbritur me shpejtësi katër persona, duke tentuar që ta fushnin brenda në makinë. Këta persona ishin pa uniformë policie, pavarësisht se prezantoheshin si të tillë. Pikërisht në këtë moment e fejuara e tij i ka pohuar me zë të lartë se katër personat nuk ishin policë, por ishin njoftuar vetë nga përbaruesi Florian Beqaraj, për të ushtruar dhunë fizike mbi Kodhelaj. Pas këtij kostatimi ai është larguar menjëherë me të fejuarën e tij, duke denoncuar ngjarjen në komisariat nr.2 në Tiranë.



Shpëtim Kodhelaj

HETIMI NGA SHKB

Shtetasi i dëmtuar Shpëtim Kodhelaj i kërkon strukturave të Ministrisë së Brendshme

Beqaraj jo vetëm që nuk e ka sqaruar por e ka kërcënuar me jetë dhe më pas e ka goditur

dhe asaj të Drejtësisë për fillimin e verifikimeve për të sqaruar pozicionin e përbaruesit Florian Beqaraj dhe katër personave të tjerë, që sipas tij vepronin si bandë krim-

inale. Kodhelaj thotë se Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm duhet të hetojë mbi rolin e katër personave të cilët prezantoheshin si policë si dhe mbi rolin e Beqarajit i cili prezantohet si mik i ngushtë i djalit të Sali Berishës, Shkëlzen Berisha, ku nëpërmjet emrit të tij kryen mashtrimet të klientëve. Sipas Kodhelaj, përbaruesi Beqaraj ka kryer shkelje të ligjit për mbrojtjen e klientit të tij dhe nisur nga kjo situatë ministria e Drejtësisë ti heqë licencën e përbaruesit.

LAJME SHKURT

■ Zgjedhjet në Lezhë, 15 vjet burg për komisionerët

Tetë komisionerët e Qendrës së Votimit në Dragushë të Lezhës janë njohur dhe me pretendencën e dhënë nga Prokuroria ndaj tyre. Komisionerët e Dragushës në Lezhë akuzohen për shpërdorim detyre dhe deformim të rezultateve të zgjedhjeve lokale të 8 majit. Ndaj tyre u kërkua 15 vite burg si dhe 2.4 milionë lekë gjobë për shkeljet e tyre gjatë procesit të votimit të 8 majit të vitit 2011. Mësohet se masa u morën edhe ndaj kryetarit dhe nënkryetarit të Qendrës së Votimit, për të cilët u kërkua që të përjashtohen për 3 vite nga funksionet publike. Sakaq më 22 qershor pritet të jepet vendimi final ndaj 8 komisionerëve, pas kërkesës së bërë nga avokati i tyre.

■ Itali, kapen dy shqiptarë grabitës profesionistë

Të rinj por hajdutë profesionistë të specializuar në vjedhjen e videopokerave. Dy djem shqiptarë të moshës 23 dhe 20-vjeçarë u akuzuan për 3 vjedhje në muajin maj dhe për këtë arsye u vunë në pranga nga policia italiane. Në 13 maj drejtuesja e një bari Olivia di Salso, gjeti derën e dëmtuar dhe njëra nga dy makinat e videopokerit ishte zhdukur me 450 euro brenda, pasi gjatë natës shqiptarët e kishin vizituar. Në të njëjtën kohë me denoncimin e gruas, denoncohet edhe zhdukja e një makine Fiat Punto. Pas marrjes së të dhënave policia nisi operacionin ku pak kilometra nga vendi i grabitjes vetëm ditën e djeshme u gjet makina brenda të cilës ndodheshin dy shqiptarët me iniciale L.G dhe D.E.

KLINIKA RADOVANI

Probleme të rënies së dëgjimit?

Nevojë për volum të lartë të TV?

Vështirësi të ndjekjes së bisedave në grup?

Nëse përgjigja është "po" drejtohuni tek "Klinika Radovani" për të zgjidhur problemin tuaj. Ofrojmë profesionalizëm dhe aparate dëgjimi dixhitale "Siemens", që janë më cilësorë në botë.

Tel: 042371735

Adresa: Rruga Hoxha Tahsin P.60/2/14, Tiranë

www.klinikaradovani.com

ALBA TECH SYSTEM



89 Euro

HP DX5150
Monitor 17"

- Procesor AMD Athlon 64 2.19 GHz
- 512 MB RAM
- 80 GB HARD DRIVE
- DVD - Rom
- Mouse dhe Tastjerë

Rr. Haxhi Dalliu,
P. 16, Shk. 1, Ap. 2,
përballë "ProCredit
Bank" Tirane - Albania
Tel: 04 22 43 299
Cel: 067 400 31 38



Trafik kokaine gjykata ekstradon drejt Italisë fierakun

Gjykata e Tiranës ka vendosur të ekstradojë në drejtim të Italisë shtetasin Andrea Brahimaj, i cili njihet ndryshe edhe me emrin Lulëzim. Vendimi për ekstradimin e tij është marrë nga gjyqtari Asim Vokshi, i cili pasi dëgjoi pretendimet e palëve vendosi të pranojë kërkesën e prokurorit Besnik Cengu, për ekstradimin në drejtim të Italisë së Brahimaj. I

ekstraduarit është nga qyteti i Fierit dhe se që nga viti 2008 rezultoi 1 dënuar me 5 vjet burg për akuzën e "Prodimit dhe shitjes së lëndëve narkotike". Ai është arrestuar duke transportuar brenda territorit Italian një sasi prej 4.680 kilogram lëndë narkotike të llojit Kokainë. Sipas dosjes të dërguar nga autoritet italiane, Brahimaj e kishte fshehur kokainën në gomën e prapme të automjetit

dhe se gjatë një kontrolli, është zbuluar me aparat skanereri sasi e drogës. Menjëherë është bërë arrestimi i tij në kushtet e flagrancës, por pas qëndrimit disa muaj në qeli, Brahimajit i është zbutur masa e sigurisë në arrest shtëpie. Sapo ka dalë nga burgu ai është arratisur, duke u kthyer në Shqipëri ku dhe ka gjetur strehim për disa vite me rradhë.

Gazetari pritët të dëshmojë në prokurori rreth botimit të librit "Enver Hoxha"

Ditari, Fevziu në prokurori

Nexhmie Hoxha dhe dy specialiste të restaurimit të dokumentave, e kanë përmendur Fevziun në dëshmitë e tyre. Punonjëset: Disa letra që ndodheshin në arkiv, i kemi parë të botuara në libër


Lajmi

Gazetari Blendi Fevziu, do jetë dëshmitari i rrallës për të dëshmuar në prokurorinë e Tiranës, lidhur me publikimin e ditarit personatë Enver Hoxhës. Janë dëshmitë e dy specialisteve restauratoreve ato që e "implikojnë" Fevziun por edhe dëshmia e Nexhmie dhe Ilir Hoxhës.

TIRANE

ELTON QYNO

Për të sqaruar rreth rrethanave të publikimit të ditarit sekret të diktatorit Enver Hoxha, pritët që shumë shpejt në prokurorinë e Tiranës të paraqitet gazetari njëherësh dhe botuesi i librit "Enver Hoxha" Blendi Fevziu. Vendimi për marrjen në pyetje të tij është marrë këtë javë nga prokuroria e kryeqytetit e cila pas tre muaj hetime rreth kësaj çështje ka vendosur të marrë dhe pretendimet e moderatorit të emisionit "Opinion". Nuk dihet me saktësi se kur Blendi Fevziu do të paraqitet në prokurori për të dhënë shpjegime, por pak kohë më parë ai ka deklaruar se ishte i gatshëm të dëshmonte para hetuesve



Enver dhe Nexhmie Hoxha

rreth të vërtetës së botimit të librit të tij, mbi jetën personale të diktatorit Enver Hoxha. Emri i Blendi Fevziut, nuk është se ka dalë rastësisht në hetimet e prokurorisë së Tiranës, pasi në dëshminë e dhënë të dy specialisteve të restaurimit të dokumentave pranë Arkivit Qëndror të Shtetit, tregohet se disa nga letrat e Enver Hoxhës që ato kanë restauruar, i kanë lexuar edhe në librin biografik të Fevziut. Këto nuk janë vetëm dëshmitë e para që përmendin Fevziun, por edhe bashkëshortja e diktatorit Hoxha, Nexhmija Hox-

ha dhe djali i saj Ilir Hoxha, të cilët kanë dëshmuar se Blendi Fevziu mund të ketë shfrytëzuar njohjet e tij për të marrë dokumentat sekrete, personale dhe intime të familjarit të tyre. Ndërkohë që dje në prokurorinë e Tiranës, kanë mbëritur materialet hetimore, me qëllim verifikimin e personave që pak ditë më parë kanë dëmtuar varrin e Hoxhës. **DËSHMITË NË PROKURORI**

Nënë e bir, kanë dëshmuar për llogari të prokurorisë së Tiranës duke ngritur dyshime të forta se punonjëset të arkivit

DEKLARATA

Fevziu: Kallëzimi penal i familjarëve komik

Kallëzimin e familjes Hoxha, gazetari Blendi Fevziu e ka quajtur si komik, pasi sipas tij vetë anëtarët e kësaj familje kanë deklaruar në media se ditarit i diktatorit ndodhej në banesën e tyre, ndërkohë që tashmë kërkojnë ta nxjerrin arkivin si shkakhtar. Sipas Fevziut, ditarët i disponon familja por ata ndoshta s'kanë pasur dijeni se një kopje tjetër ndodhej në Arkivin e Shtetit. "Ky reagim ka nisur menjëherë pasi unë botova në informacionin për librin që pritej të dilte. Bëhej fjalë për disa dokumente që ata janë befazuar nga publikimi i tyre. Ndoshta nuk e dinin se kopjet ishin ruajtur nga Komiteti Qendror dhe sot ndodhen në Arkivin e Shtetit"-ka deklaruar në një të përditshme Fevziu.

ose vetë gazetari Blendi Fevziu mund ta kenë marrë ditarin nga fondi "Enver Hoxha" dhe më pas botimin e tij në një libër të vetëm. Këto dyshime, erdhën që në fillim nga Nexhmie Hoxha, e cila konstatoi fletët e ditarit të diktatorit Hoxha në librin e gazetarit Blendi Fevziu. Thuajse në të njëjtën linjë kanë qëndruar edhe dy restauratorët e dokumentave, që kanë treguar në prokurori se në arkivë nuk ndodhej ditarit i Enverit, por në fondin përkatës ishin arkivuar vetëm disa letra dhe parrulla të diktatorit. Këto letra janë restauruar, pasi për

shkak të kohës së gjatë, ishin prishur nga kushtet atmosferike. Dy restauratorët i kanë thënë hetuesve të çështjes se disa nga letrat që kishin restauruar, i kanë parë më pas edhe në librin e gazetarit Blendi Fevziu. Për të gjitha këto tashmë ky i fundit, pritët të paraqitet në prokurori për të dhënë pretendimet e tija mbi rrethanat e botimit të librit. Ndërkohë që drejtoresha e arkivit Nevila Nika, ka mohuar çdo dyshim të familjarëve duke pretenduar se nuk ka asnjë dijeni se si mund të kenë dalë dokumentat nga arkivi.

LAJME SHKURT

■ Shkodër, grabisnin motorat katër të arrestuar
Policia e Shkodrës ka arrestuar katër persona të cilët akuzohen për grabitje të disa motorëve, biçikleta dhe mjete pune të llojeve e markave të ndryshme. Në pranga kanë ranë Sokol Marku, 21 vjeç, i dënuar më parë për veprën penale të vjedhjes, banues në fshatin Rrenc, Pal Tatjonaj, 21 vjeç, i dënuar dy herë për veprën penale të vjedhjes, Gjin Aroni, 23-vjeç, banues në fshatin Bardhaj, dhe Albert Keçaj 21-vjeç banues në fshatin Grudë e Re. Arrestimi i tyre është bërë mbremjen e djeshme rreth orës 22:00. Ndërkohë që është shpallur në kërkim dhe Pashko Qarri, 19-vjeç, banues në lagjen Guerile, të qytetit Shkodër.

■ Keqtrajtoi të atin, arrestohet 43-vjeçari
Një person është arrestuar dje nga policia e Tiranës pasi ka rrahur barbarisht babanë e tij. Në pranga ka rënë Agron Saçi, 43-vjeç, banues në Vaqar të Tiranës. Saçi, pas një grindje me babain e tij 69-vjeçar Murat Saçin e ka qëlluar këtë të fundit me sende të forta, duke i shkakuar dëmtime serioze. 69-vjeçari është dërguar nga të afërmit e tjerë në spital dhe është shtruar në reanimacion në Spitalin Nënë Tereza. Gjendja e tij shëndetësore mësohet se është e rëndë.

■ Kapet shpërndarësi i drogës në Gjirokastrë
Një shpërndarës i lëndëve narkotike është arrestuar në qytetin e Gjirokastrës. Blendi Lato, 30-vjeç, lindur dhe banues në Elbasan është kapur nga forcat e policisë me 100 gramë mariuanë, e bërë gati në sasi të vogla për ta shpërndarë. Policia ishte vënë në ndjekje të 30-vjeçarit që banonte prej kohësh në Gjirokastrë dhe ka arritur ta arrestojë mbremjen e djeshme në afërsi të tregut të fruta perimeve të qytetit. Si pas policisë, dyshohet se ai blinte lëndë narkotike në fshatin Lazarat dhe e shiste në sasi të vogla në Gjirokastrë, kryesisht adoleshentëve.

Kultivimi i hashashit

Ndalohej 45 punëtorë "droge" në Lazarat

TIRANE

Policia e Gjirokastrës ndalon të tjerë punëtorë që tentojnë të shkojnë drejt Lazaratit për sezonin e mbjelljes së kanabisit. Burme nga policia e Gjirokastrës bëjnë me dije se janë ndaluar 45 persona të cilët udhëtonin me 4 furgonë drejt fshatit më të njohur në vend për mbjellje dhe kultivim të kanabisit. Ndali-mi i tyre është bërë në postbllokun e ngritur nga policia në dalje të qytetit të Gjirokastrës, rreth 3 km larg Lazaratit. Forcat e policisë kanë ndeshur fillimisht në kundërshtimin e drejtuesve të furgonëve të cilët kanë deklaruar se ata thjesht po conin



Droga në Lazarat

pasagjerë në Lazarat dhe se ndalimi i tyre është i padrejtë. Gjithsesi aksioni i policisë për ndalimin e 45 personave nuk është shoqëruar me rezistencë. Një ditë më parë u ndaluan 100 persona, të cilët udhëtonin me 7 furgonë drejt Lazaratit. Sipas burimeve policore të cilave u referohet A1 Report, të 100 personave kryesisht gra, u është marrë deklarata me shkrim se çfarë punë kryejnë në Lazarat dhe cilët janë punëdhënësit e tyre duke u nënë dijeni se në rast shkelje të ligjit, do të penalizohen. Tashmë kultivuesit e drogës në Lazar për të mos rezikuar shumë, si dhe duke shfrytëzuar kushtet e vështira ekonomike të banorëve

të zonës por dhe jo vetëm, mbjellin lëndën narkotike me persona që nuk janë banorë të fshatit. Pak kohë më parë kryetari i komunës Lazarat Dashnor Aliko deklaroi për mediat se në komunën e tij nuk është mbjellë asnjë parcelë me drogë. Ndërkohë që tashmë vëmendja maksimale e Policisë së Shtetit është fokusuar pikërisht në këtë zonë, e cila tashmë njihet dhe ndërkombëtarisht për kultivimin në sasi të mëdha të marjanes dhe hashashit. Ndërkohë që janë regjistruar dhe shumë raste të kapura, ku persona të pa identifikuar kanë tentuar ta trafikojnë drogën në drejtim të shtetit Grek.



STUDENTJA DEL NGA KOMA

Eriselda Gubere, njëra prej studenteve të Elbasanit, e aksidentuar në Himarë më 21 maj, ka dalë dy ditë më parë nga koma. Megjithatë, mjekët austriakë, të cilët po e kurojnë thonë se gjendja e saj shëndetësore paraqitet disi e vështirë për shkak të ndërhyrjeve të shumta kirurgjikale. Ndërkaj, studentja tjetër Florije Peçi vijon të mbetet në koma, në spitalin e Austrisë.



FËMIJËT ME DEFEKTE NË ZEMËR

Dhjetë fëmijë, të cilët kanë lindur me probleme të rënda në zemër do të operohen në një nga spitalet më të specializuara të kardiologjisë në Itali. Kjo falë marrëveshjes që ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar me spitalin "Gaslini", i cili mundëson edhe 30% tarifa më të ulëta për të gjithë shqiptarët që jetojnë në Itali. Në Shqipëri lindin me defekte në zemër mbi 350 fëmijë.

Pacientët e mbushin te lokalet, spitali: E shpërdorojnë vetë

Ushtaraku 'thahet' për ujë të pijshëm

Mjekët: Nuk kemi as për të larë duart

Lajmi

Në spitalin Ushtarak, dje, duke filluar nga ora 06:00 e mëngjesit deri në 15:00 nuk ka pasur asnjë pikë ujë të pijshëm. Mjekët japin alarmin se kjo është një situatë skandaloze, ku ata nuk kanë as ujë për të larë duart, përpara se të mjekojnë plagën e pacientit, ndërsa pacientët mbushin bido-nat në lokalet përreth.

■ ■ ■ TIRANE

ESMERALDA KETA

Në çezmat e pacientëve të shtruar nëpër pavijonet e këtij spitali, apo dhe në dhomat e mjekëve, uji mungon në pjesën më të madhe të kohës, por edhe kur ka vjen me pikatore, për shkak të nevojave të shumta që ka ky institucion. Më problematike, sipas vetë mjekëve ka qenë dita e djeshme, ku ndryshe nga herët e tjera, kur uji mungon gjatë gjithë natës, ai nuk ka ardhur edhe gjatë ditës nëpër rubinetat. Situata është më e rëndë të shërbimi ku vijnë traumat, të cilat duhen pastruar dhe mjekuar me kujdes, ndërkohë që gjithçka dje ka qenë në një situatë jo e favorshme për shkak të mungesës së ujit. "Mirë që nuk kemi ilaçe, medikamente, apo çdo gjë tjetër, por tani nuk kemi as ujë për të larë duart. Dhe kjo është e tmerrshme. Sot (dje) nuk ka pasur ujë gjithë ditën. Unë jam mjek dhe për të larë duart para se të mjekojta të sëmurin, më është dashur të kërkoh ujë borxh tek të sëmurët e tjerë sepse spitali nuk kishte asnjë pikë. Dhe ky është një skandal. Vetë pacientët, kanë marrë bido-nat dhe kanë dalë duke mbushur ujë te lokalet këtej rrotull ose tek ndonjë shtëpi që i hap derën. Është e tmerrshme. Mirë që nuk ka gjithë natën, por mungon edhe ditën", - na thotë i irrituar njëri nga mjekët e këtij spitali. Sipas tij një spital pa ujë mund të jetë një rezik i madh, jo vetëm për pacientët, por edhe për të gjithë personelin që punon aty. Kjo pasi, mund të bëhet shkak për shpërthimin e një epidemie. Në çezmat e dhomave të pacientëve, por edhe në ato të mjekëve, numërohen me gishtat e njëres dorë orët kur ka ujë të rrjedhshëm. Pacientët na pohojnë se mesatarisht çdo ditë u vjen tri orë ujë, ndërkohë që



Bidonat me ujë te dhomat e pacientëve në Spitalin Ushtarak

gjatë natës ai mungon pothuajse fare. Si pasojë e kësaj mungese të te zgjatur, ata e blejnë ujin për të plotësuar nevojat që kanë, por problem mbeten tualetet e spitalit, të cilat nuk kanë ujë rezervë. "Është problem uji i pijshëm, pasi ai vjen me orar dhe nuk arrijn të plotësojnë nevojat e spitalit. Ne e blejmë vetë, por problem janë banjo", - shprehet njëri i afërm i një pacienti të shtruar te Ushtaraku. Ndërkohë që të njëjtën situatë pohojnë edhe mjekët, të cilët shprehen se nuk dinë ku të trokasin, në mënyrë që

kjo situatë të marrë fund. "Është e paimagjinueshme që një spital të mos ketë ujë. Në vend që të shërohet, këtu e merr fare mirë infeksionin, pasi nuk ka ujë as për të larë duart. Është absurde që ne të kemi të njëjtat orare me familjarët përreth nesh", - shprehet një mjek i këtij spitali, i cili sqaron se spitali nuk favorizohet në oraret e furnizimit me ujë. Ndërkohë që burime nga Ujësllësi shprehen se ky spital nuk ka kufizime në oraret e furnizimit dhe për asnjë moment nuk i është ndërprerë uji

i pijshëm. Të njëjtat burime shtojnë se nëse ky spital nuk arrijn të plotësojnë nevojat, të vendosë depozita dhe të ketë ujë rezervë.

SPITALI

Sipas drejtorisë së këtij spitali, Ushtaraku ka depozita me ujë të pijshëm, që plotësojnë nevojat që kanë të gjitha shërbimet. Ata thonë se spitali nuk vuan për ujë të pijshëm, por nuk ngurrojnë t'u bëjnë apel pacientëve dhe të afërmeve të tyre që të mos i shpërdorojnë ujin e pijshëm duke lënë çezmat hapur, por të kujdesen që

Mungesa

Ujësllësi shprehen se ky spital nuk ka kufizime në oraret e furnizimit dhe për asnjë moment nuk i është ndërprerë uji i pijshëm

depozitat të mos boshatisen kot. "Ne furnizohemi normalisht me ujë dhe nuk kemi probleme me ujin e pijshëm. Madje ne kemi edhe depozitat e mëdha, që shërbejnë për të plotësuar nevojat e spitalit kur nuk i plotëson ai i rrjetit të ujësllësit. Por duhet të kemi parasysh që jo vetëm numri i pacientëve që ne përballojmë është rritur, por vijnë edhe me qindra familjarë që ndikojnë në rritjen e konsumit të ujit brenda spitalit. Ne u bëjmë dhe u kemi bërë vazhdimisht thirrje që të mos lënë rubinetet e çezmave hapur, duke u bërë shkak që depozitat të harxhohen në kohë rekord, por edhe ata të jenë të kujdesshëm që asnjë pikë ujë të mos ikë kot", - na shpjegojnë burime pranë drejtorisë së spitalit ushtarak në Tiranë.

LAJME SHKURT

■ Sëmundjet e rralla, preken 20 fëmijë

Janë prekur nga sindroma "gaucher", pasi iu mungon një enzimë, e cila sjell zmadhim të mëlçisë apo shprekës. Kjo enzimë u injektohet pacientëve disa herë në muaj dhe nuk i pengon ata të kryejnë një jetë normale. Janë rreth 20 fëmijët me këtë sëmundje, që është e lindur dhe që për herë të parë është diagnostikuar në vendin tonë në vitin 2003. Në simpoziumin e organizuar nga shërbimi i gastro-hepatologjisë Pediatricë, shefi, Paskal Cullufi, ka kërkuar që pacientët të rimbursohen për medikamentet e tyre, pasi kura kushton të paktën 100 milionë lekë në vit. "Të krijohet një fond i posaçëm nga shteti, pasi mjekimi i tyre është shumë i shtrenjtë", - ka deklaruar Paskal Cullufi.

■ Në nëntor gati projekti teknik i bulevardit të ri

Brenda nëntori përfundon projekti teknik i bulevardit të Tiranës me gjatësi 1.8 km. Kryebashkiaku Basha i pranishën në ekspozitën e hapur nga Fakulteti i Arkitekturës, Universiteti Politeknik i Barit, "Arkitektura moderne italiane në Tiranë, vazhdimësia e një ideje", bëri të ditur se puna në bulevard do të nisë shumë shpejt. "Ky projekt do të urbanizojë këtë zonë të populluar kohët e fundit dhe do të kthehet në një qendër vërtet tërheqëse për Tiranën dhe gjithë shqiptarët", - deklaroi Basha në fjalën e tij. Me mbështetjen financiare të BE-së, do të nisë puna për sheshin e Drejtësisë, ku një kontribut të rëndësishëm jep dhe shteti italian.

■ LGBT, faqe interneti kundër diskriminimit

Komuniteti LGBT, në promovim të diversitetit seksual ka vendosur të hap një website në titullin "My story, historia ime". Këtë herë, edhe nëpërmjet internetit, përfaqësuesit e këtij komuniteti do të llobojnë për t'i thënë "stop" diskriminimit dhe fyerjes publike ndaj personave që kanë orientim të ndryshëm seksual. Por, në website do të publikohen edhe histori individuale dhe vështrësiet e përjashtimit që ndeshin këta persona në familje e shoqëri. Kjo ishte e para konferencë rajonale që promovon diversitetin seksual me pjesëmarrje të LGBT nga 17 vende të ndryshme të botës. Konferenca i mbylli punimet z 3 ditore duke sensibilizuar edhe mediat për raportimet të aktivitetëve të tyre.

Pemët e prera

Dalipi: Bashkia të japë llogari

■ ■ ■ TIRANE

Këshilltarët socialistë kanë akuzuar bashkinë e Tiranës se ka prerë pemët në parkun e Liqenit Artificial të Tiranës, se nuk ka asnjë vendim apo projekt që të ketë kaluar më parë në këshillin bashkiak. Sipas këshilltarëve socialistë Aldrin Dalipi, Gent Gazheli dhe Florian Pullazi për prerjen e pemëve në këtë park që ka status të veçantë duhet një leje e posaçme, gjë e cila nuk ka ndodhur, ndaj kanë kërkuar që prokuroria të nisë hetimet. "Mijëra metra katrorë janë shkatërruar brenda një nate. Ne i kërkojmë kryetarit të Bashkisë së Tiranës, të dalë menjëherë publikisht, të bëjë transparencë dhe të

shpjegojë mbi çfarë baze ligjore, mbi çfarë akti e ka marrë këtë vendim? Ku janë bazuar autoritetet e bashkisë së Ti-

Lajmi

Bashkia e Tiranës ka hedhur poshtë akuzat e këshilltarëve socialistë për prerjen e pemëve përballë fakultetit të Filologjisë. Sipas Bashkisë në këtë zonë po punohet për zgjerimin e rrugës së Elbasanit, me gjatësi 1.7 km do të jetë me 6 korsi 2x8m, me trafikndarëse prej 1.5 m, ku është parashikuar dhe gjelbërim, si dhe me trotuare në të dy anët e rrugës

ranës, që kanë ndërhyrë dhe kanë kryer këtë veprim që për ne konsiderohet antiligjor? I kërkojmë kryebashkiakut Basha të bëjë publik vendimin se ku e ka bazuar këtë ndërhyrje të pandodhur më parë. Këshilltarët e opozitës nuk kanë asnjë dëgjim apo vendimarrje për goditjen e Parkut Kombëtar. Basha të mos fshihet pas njoftimeve për shtyp, pasi ky është një akt i papranueshëm. I kërkojmë Prokurorisë së Tiranës të nisë menjëherë hetimet", - ka deklaruar dhe kreu i këshilltarëve socialistë, në këshillin bashkiak të Tiranës, Aldrin Dalipi. Sipas këshilltarëve socialistë, me këtë vendim bashkia e Tiranës ka shkakuar një dëm të madh mjedisor, duke prerë pemët në këtë zonë.

Flisni gjatë gjithë kohës, me këdo dhe kudo që ndodheni!



AMC universal

Paketa dyjavore për të gjithë klientët me parapagesë

- 2000 MIN + 2000 SMS drejt AMC
- 20 MIN Kombëtare
- 200 MB Internet **3G**

Vetëm 600 lekë

E SHOHIM BOTËN SI TI
PLOT OFERTA



www.amc.al

e shohim botën si ti

Paketa vlen për 14 ditë. Çmimi është me TVSH. Oferta vlen për një kohë të limituar.



LINDA HALIMI
GATI BASHKEPUNIMI
ME LEONORA POLOSKEN



BIG BROTHER 5
LARGOHET EVELIN
TERBOHET LIAMI




WWW.SHQIPTARJA.COM

Suplementi i së shtunës te SHQIPTARJA.com

THASH & THEM

NR. 19 E shtunë, 16-06-2012

em@shqiptarja.com



ERIK LLOSHI
UNE DHE MUZIKA
TASHME JEMI NJE



ALTUNA SEJDIU
Dilema për titullin
e albumit të ri



LEDION LIÇO

EKSKLUZIVE
FLET
MODERATORI

**JA PSE DO JEM
SERISH NE "THEVOICE"**
JETA PRIVATE DHE PUSHIMET NE NEW YORK


ELVANA GJATA
Femra e parë
që rrëmben
trofeun e DWS



ARDIAN BUJUPI
SE SHPEJTI NE NJE
DUET ME NOGEN



SHEILA HAXHIRAJ
Unë një
produkt 100%
i X-Factor



ROZANA RADI
BESOJ TE
DREJTESIA JAM
E PAFAJSHME



FLASIN 4 FINALISTET
FITORJA E ELVANA
GJATES ISHTE E MERITUAR



LEDION LIÇO:



Këtë vit për këto tre muaj, ashtu siç bëhej nëpër kampe verore dikur "The Voice" do të hap ato që quhen "Summer Training"

Ja pse zgjodha të jem sërish në "The Voice"

Liço rrëfen jetën private dhe pushimet e "çmendura" në New York

SUADA DACI

Për të dytin vit radhazi do të jetë ai që do të drejtojë spektaklin e talenteve të reja, "The Voice of Albania". Ledion Liço i është besuar përsëri drejtimi i këtij spektakli, që pritet të startojë në fillim të tetorit në Top Channel. Moderatorin e takojmë në studiot e Top Albania Radios, ku sapo ka përfunduar emisionin "Wake Up", e ku na flet për risitë e edicionit të dytë të "The Voice". "Ndiem shumë i emocionuar, sepse përveç faktit që është një program që të emocionon ekziston edhe kërsëria për të zbuluar talente të reja", thotë Liço. I njohur për eksperiencat e shumta televizive në shumë spektakle në Top Channel, Liço e veçon këtë format sepse atmosfera dhe njerëzit janë vërtet të këndshëm dhe bëjnë të ndihet komod. Moderatorin, Ledion Liço, në këtë intervistë ndan me ne edhe disa gjëra nga jeta e tij private dhe flet me shumë pasion për , Jobs "shokun" e tij më të ri.

Përsëri pjesë e "The Voice of Albania", si ndiheni?

Ndiem shumë i emocionuar, përveç faktit që është një program që të emocionon, jo aq për shkakun e pozicionit tim aty, sepse është shndërruar në një lloj rutinë, por për shkak të kërsërisë që ekziston për të gjetur talente të reja, për të gjetur element të cilët është e sigurt që do të shndërrohen në zërat e ardhshëm muzikor, si dhe për të parë emocion për së gjalli për të cilin kemi aq shumë nevojë. Duke patur parasysh pozitën politike, ekonomike dhe sociale në Shqipëri njeriu ka nevojë të shohë , emocione "allo stato puro", (në gjendje të pastër), kështu që jam vërtet me pritshmëri shumë të larta. Mirëpo dua të them që unë mezezi pres të mbaroj "Wake Up" dhe pastaj do të bëj disa pushime në New York.

Kanë filluar audicionet e "The



Voice"?

Audicioni i parë ka nisur në 14 qershor në Tiranë, pastaj do të jetë përgjatë gjithë Shqipërisë, më pas do të shkojmë në Kosovë, në Maqedoni, etj. Audicionet do të vazhdojnë përgjatë gjithë muajve të verës, për të marrë sa më shumë njerëz. Duke qenë se muajt e verës janë më shumë muaj pushimi, ndaj e kemi shtrirë këtë fazë të audicioneve, derisa të shkojmë në fazat e forta të përzgjedhjes.

Kemi vënë re që bëheni një me konkurrentët, i përjeton njësoj emocionet me ta?

Është dhe formati që të bën ta përjetosh atë pjesë kur kthehet karrigia. Unë në të sh-

kuarën i kam përjetuar vet ethet e konkurrimit dhe e ndjej shumë këtë pjesë. Por mund të them se është e pamundur mos të emocionohesh mes këtyre të rinjve dhe të reja, që duan të dëgjojnë. Mos mendoni që ata kanë ëndrra për tu bërë yjet e skenës, ata kanë thjesht dëshirë të dëgjojnë dhe të vlerësohen pa vetulla të vrenjtura, pa ju thënë se ka dhe më të mirë se ty. Ne duhet të kuptojmë ndonjëherë sesa e rëndësishme është që tjetri të dëgohet dhe të evoluojë për atë që është.

Çfarë ju tërheq tek ky spektakël?

Miriam Cani (qesh)..

Përveç Miriamit?

Bëj shaka. E para më pëlqen stafi sepse është shumë i mirë, që dinë ti japin secilit atë që meriton. Pastaj më pëlqen fryma që është krijuar në grup, batutat që shkëmbehen kjo është ana e dukshme në ekran. Ana e dukshme pastaj them se secilit i jepet ajo që meriton, punohet me potencialin e konkurrentëve çdo javë shihet ndryshimi, u jepen mundësi pa fund për tu përmirësuar. Këtë vit për këto tre muaj, ashtu siç bëhej nëpër kampe verore dikur "The Voice" do të hap ato që quhen "Summer Training", dhe të gjithë ata që do të shkojnë në audicione përpara se të shkojnë tek audicionet e fshehura, do të familjarizohen me situatën, mikrofonin, me orkestrën, me kamerën, etj.

Pra, do të kemi risi në këtë edicion të dytë të "The Voice"?

Absolutisht që po, kjo është një risi . Kam idenë që kjo që përmenda më sipër nuk bëhet as jashtë. Është një mundësi që do ti çlirojë konkurrentët nga emocionet, dhe do ti udhëzoj ata. Për shembull ne kemi patur vjet, këngëtarë shumë të mirë që këngët e tyre i kishin zgjedhur gabim, Drilon Shala ka qenë njëri prej tyre. Dhe duke patur parasysh këtë është mirë që të punohet me disa njerëz që ti

udhëzojmë drejt rrymës që i përshtaten më shumë. Në këtë mënyrë edhe ata që mendojnë se nuk kanë shumë mundësi, përkundrazi duhet të vijnë të punojnë me profesionistë si Kamela Islami, Landi Kademin, që kanë qenë asistentë të trajnerëve kryesor, do të punojnë me ta përgjatë gjithë muajve të verës.

Besoni se do të ketë suksesin e të parit?

E besoj shumë. Po lexoja këto ditë intervistat përpara se të niste "The Voice", dhe megjithëse kishim një dëshirë dhe pritshmëri të madhe nuk dinim sesi do të shkonte ky spektakël. Por duke qenë se u punua me shumë dashuri , jemi shumë të bindur që do të ketë po atë sukses.

Kur do të startojë "The Voice of Albania"?

Datë fikse nuk kemi ende, por bëhet fjalë për fund shtatori fillim tetori, që është edhe nisja e sezonit të ri televiziv. Dihet që Top Channel e ka si armën e tij të parë, "The Voice of Albania". Nëse ka dy projekte ato janë, Big Brother dhe "The Voice". Do të kemi një studio të re që do të ofrojë shumë më tepër sesa në sezonin më parë. E rëndësishme është që do të nis dhe siç e kam shkruar në Facebook, "is going to be better and bigger" dhe më gjithëpërfshirës.

Më thatë që "The Voice", është një nga projektet më të mëdha të Top Channel, dhe ju jeni pjesë e tij ndjeni më shumë përgjegjësi?

Është një ndenjë përgjegjësie, por një profesionist i mirë është i përgjegjshëm për çdo moment që del përpara publikut të tij. Qoftë edhe në një transmetim, që në dukje është i vogël në radio, ku unë vazhdoj të angazhohem ende. Natyrisht përgjegjësia vjen duke u shtuar por parimi im është të bëj qejf. Kur unë bëj qejf njerëzit kënaqen, dhe kjo është nor-

male na ndodh në çdo ambient. Thjesht është një ndenjë ledhatimi i egos.

Si arrini ti bëni të gjitha?

Mundohem të kem informacion, të jem rehat me atë që bëj dhe mbi të gjitha bëj gjëra që më pëlqejnë ti bëj. Dhe kur njeriu bën atë që do nuk ka vend për lodhje sepse kënaqem, por kur ka ca lekë në fund të muajt është akoma edhe më mirë (qesh).

I ndjek programet e tjera konkurrante dhe çfarë do të sjellësh ndryshe tek publiku?

Në televizion secili shikon nga tjetri për të ecur më mirë. Parimi "Stalinist" shiko konkurrencën që të ecësh përpara vazhdon të ngelet ende në fuqi, por unë nuk i shoh produktet televizive nga këndvështrimi im. Mundohem që ta ndaj veten time si prezantues, dhe i shoh si publik. I gjykoj duke patur pritshmëritë e mia për atë që shoh. Këtë gjë e bëj edhe me programet e mia. E vë veten në vend të publikut dhe do të mendoja nëse do ta shoh apo jo këtë program. Kjo mund të jetë edhe subjektive, por më mirë ta dish që je sesa të mundohesh që je objektive dhe të mos jesh asgjëkundi. Në këtë pikë natyrisht që i shoh konkurrentët, shoh si punojnë, si prezantojnë, por një gjë që më bën të lumtur është që talenteve të reja, është duke u dhënë një shans. Dhe kur them talenteve të reja, nuk do të doja kurrë që të abuzohet me këtë fjalë qesharake, edhe nga njerëz që donin të bënin para më këtë punë. Mendoj që është një gjë shumë e mirë sa më shumë të ketë , aq mirë. Aq më shumë zëra të mirë, aq më mirë për Shqipërinë.

Shumë nga pjesëmarrësit e "The Voice" ishin pjesë e Top Fest. U ndjetë pak më shumë krenarë, që këta këngëtar, të cilët dolën nga ky format morën pjesë në këtë event?

Kur shikoj talent shou-t e huaja dhe kur shikoj prezantuesit që thonin se ata ishin të vetët, më dukej pak si qesharake. Por në fakt duket sikur i ke vërtetë të tutë në një sens, pasi janë njerëz që ke bashkëjetuar për një kohë të gjatë dhe kur i shoh në një format tjetër të bëhet qejfi. Ata ishin në Top Fest dhe për mendimin tim personal rrugëtimi i tyre duhet të zgjaste shumë tepër. Unë kam bërë me aq sa kam mundur që ti angazhojë në hapësirat e mia mediatike, sepse ata meritojnë shumë. Ata mund të bëhen shumë më tepër se këta këngëtar që kemi aktualisht, mjafton t'u jepjen shanset e duhura. Por ata e kanë pak të vështirë sepse kur këndojnë këngët e këngëtareve të huaj u duket diçka më e lehtë, por në momentin kur fillojnë bëjnë këngët e tyre edhe publiku është mësuar ti shoh si interpretues. Kjo ishte një sprovë për ta por edhe për produksionin, që publiku arriti t'i gjykonte ata edhe si këngëtar të muzikës së tyre.

Keni vite që jeni pjesë edhe e Top fest, si ju duk Top Fest 9?

Ishte siç do vit në kuptimin që Top Fest sjell diçka të re, pasi që prej edicionit të 6 ka çdo vit nga një autor të ri. Top Festi varet shumë nga prurjet, ndaj ka vite që unë jam shumë i apasionuar prej tij, ndërsa ka vite që nuk jam fare.

Kishit një këngë të preferuar këtë vit?

Kisha një këngë që nuk hyri në finale, kënga "Lutem për shije", e Shpat Dedës. Për mendimin tim është kënga më e mirë e vitit në Shqipëri, duke hequr këto nocionet "Mamica", që janë shumë të njohura.

Këtë vit kishte shumë këngëtar të pakënaqur?

Për hir të së vërtetës ka patur gjithnjë. Në një garë ka gjithnjë të pakënaqur aq më tepër në Top Fest, ku gara është shumë e fortë dhe secili, do të tregojë aftësitë jo vetëm të zërit, por edhe të performancës. Unë nuk jam marr fare më këtë pjesë dhe nuk kam për të marr pjesë asnjëherë.

Kemi venë re që jeni një nga prezantuesit me një luk të veçantë, si do të jetë Ledioni në "The Voice", do të jeni bjond, brunë, pa flokë?

Nuk e di fare, vetëm pa flokë jo. Kjo puna e ndryshimit që njerëzit e vënë në dukje, është një gjë që më vjen natyrisht.

Konsultoheni me dikë për lukun tuaj?

Me mikun tim internetin është një yll i vërtet (qesh), thjesht futesh aty dhe ai tregon të gjitha.

Mendonin pamja që është pjesë e rëndësishme për një prezantues në ekran?

Nuk mendoj që është pjesë e parëndësishme, por nuk mendoj që është pjesë e domosdoshme. Prezantuesit më të mirë apo ata që preferoj unë nuk kanë qenë të paraqitshëm, për nocionin tonë të paraqitjes fizike, sepse natyrisht secili nga banorët e këtij planeti ka nocionin e tij për bukurinë fizike. Unë jam për atë që njeriu bëhet i bukur nga mënyra sesi sillet, sesi komportohet me njerëzit. Në ndonjëherë mbajmë për të bukur njerëzit më të shëmtuar dhe për të shëmtuar njerëzit më të bukur në këtë botë.

Trajnerët e "The Voice" do të jenë të njëjtët?

Në foto: Ledioni Liço



Po do të jenë po ata. Urojmë mos të kemi ndonjë surprizë, por besoj se do të jetë katërshja fantastike. Janë 4 njerëz të shkëlqyer të cilët kanë krijuar një raport shumë të mirë me konkurrentët dhe me publikun. Jam i sigurt që do ta bëjnë edhe më mirë detyrën gjatë sezonit të ri. Kështu që pse të ndryshojnë (qesh).

Kemi marr një vesh që ju keni marr një qen, ç'është ky qen kush u'a ka dhuruar?

Ky qen është një dhuratë nga dy miqtë e mi, Eno Popi dhe Suela, të cilët menduan të më bënin më të përgjegjshëm duke më blerë një qen. Dhuratat janë të bukura se të blejnë përshembull, një palë këpucë, por kur të blejnë një qen ai do përkujdesje. Unë sot jam zgjaur në 2 të natës, sepse ai është shumë i vogël dhe ka filluar të urinojë gjithandej nëpër shtëpi. Është një përgjegjësi që i bën mirë njeriut, por mendojë se këto dhuratat janë të mira kur i mendon për një kohë më të gjatë.

Mos ndoshta Ledioni është i "përgjegjshëm", që shoqëria ka menduar ta bëjë të përgjegjshëm?

Jo shoqëria është e papërgjegjshme, që kërkon të më ngatërrojë mua në të tillë "qorrosokak", po unë zgjidha ta mbaja atë qen sepse mu duk kaq i mirë.

Si quhet qeni?

Qeni quhet Jobs, si Steve Jobs, është një emër që ja ka vënë mikja ime, Arbana Osmani.

E shoh që flisni me shumë pasion për të?

Hajde më pyet pas 3 javësh se tani jemi në fillimet tona (qesh).

Përveç Jobsit që ju po përkujdesni kaq shumë, po përkujdesni për dikë tjetër?

Jo nuk përkujdesem për asnjë nga ato natyrat që thoni ju. Shiko edhe sikur të përkujdesha unë pse duhet ta dini ju, (qesh). Është një gjë që e kam thënë dhe do ta rithem për gjatë gjithë kohës, është diçka që nuk do doja ta ndaja me mediat, sepse është diçka që më përket mua. Megjithatë kur të vij momenti mbase mund të bëjmë diçka publike, por tani nuk ka asnjë person të rëndësishëm në jetën time.

Në fillim të intervistës me thatë diçka për pushimet tuaja në New York, pse zgjodhët pikërisht New Yorkun për të pushuar?

Sepse njeriu ka disa destinacione që duhet të shkojë pasi kalon disa kohë të vështira. Pasi kalon një ditë të vështirë në zyrë njeriu duhet ti bëjë një vizitë kreativit, pastaj gjatë një periudhe të gjatë në punë njeriu shikon një fundjavë në jugun tonë, sidomos gjatë kësaj periudhe që nuk ka shumë njerëz. Dhe njeriu pasi lodhet për shumë kohë duhet të shkojë në New York, pasi duhet të ballafaqohet me një mënyrë tjetër të të jetuarit. Unë e kam shumë qejf mundohem që ëndërrën time amerikane ta bëjë në Shqipëri, jo për faktin që nuk kam patur mundësi të shkoj atje, por për faktin që e kam të pamundur të lë njerëzit që i dua fort. Të ishte për punën që bëj apo për Shqipërinë do ta lija që nesër, por e di çfarë në një vend nuk të mban aq vendi por njerëzit. Dhe guri i rëndë nuk është në vendin e vet, por pas shkëmbinjëve që ka rreth e rrotull, pa të cilët nuk mund të jetojë.

Cilat kanë qenë pushimet tuaja më të çmendura?

Uroj të jenë këto shumë të "çmendura", megjithatë pushimet tona janë shumë të çmendura sepse bëhemi një grup simpatik. Këtë vit në New York do iki me dy miqtë e mi shumë të mirë me, Eno Popin dhe Elona Duron, me të cilët kemi ndarë shumë eksperiencë.

Do doja të dija nëse keni patur oferta për të shkuar në ndonjë televizion tjetër, dhe a ke menduar të shkëputesh nga Top Channel?

Nuk ka më të mirë se Top Channel në Shqipëri, dhe kjo jo për faktin se unë punoj në këtë media. Nuk kam patur ndonjëherë mendje për tu shkëputur sepse ndihem mirë këtu, ndihem i përkrahur dhe i mbështetur kështu që nuk kam ndjerë arsye reale për tu larguar. Por nëse do të vinte ajo ditë nuk do të ishte fundi i botës, përkundrazi për asnjë nga ata që kanë qenë në Top dhe kanë ikur, apo anasjelltas. Mirëpo është vërtet qejf të punosh në Top, ngaqë je i pari duhet të punosh si i pari dhe mbase kjo mund të ishte përgjigjja, kur më pyetet sesi i bëj të gjitha. Ndoshta është edhe presioni i Topit, që më detyron ti bëj të gjitha.

Mes radios dhe televizionit ku ndiheni më mirë?

Për çështje sadsifaksioni është televizioni ai që të jep më shumë, për faktin se shihet më shumë në Shqipëri. Por mua ka filluar të më shijoj shumë edhe kjo puna e mbrapa skenës dhe në këtë drejtim e kam shumë të sigurt, që jo shumë larg do të vij momenti që unë do të filloj të tërhiqem nga televizioni për t'u marr me prapavijën. Por gjithmonë nëse do të jem me këto mendje sepse mendjet e mia ndryshojnë shumë (qesh).



ELVANA GJATA

Femra e parë që rrëmben trofeun

Ja prapaskenat e mbrëmjes së fundit të vallëzimit të yjeve

XHULIA KARAVELLA

Ka mbyllur siparin mbrëmjen e të enjtes edicioni i tretë i "Dancing With The Stars", duke kurorëzuar fituese këngëtarene Elvana Gjata. Ajo është e para konkurrenente femër pas Oni Pustinës dhe Enver Petrovit, që ka arritur të jetë fituese e këtij reality show. Menjëherë pas marrjes së trofeut Elvana ka shprehur mirënjohjen e saj për balerinin që e ka shoqëruar në këtë aventurë, Gerd Vason dhe balerinën e famshme Enada Hoxhën. Këngëtarja ka mundur të bëhet fituese e një apartamenti luksoz i mundësuar nga kompania EDIL AI. Megjithatë formati i sivjetshëm i spektaklit ka befasuar me ndryshimet e shumta si në formulën e eliminimit, ashtu edhe në numrin e finalistëve. Këtë vit në skenë u ngjiten gjashtë konkurrentë të cilët ishin, Zhaku, Vedat Ademi, Foto Strakosha, Elvana Gjata, Xhani Shqerra i rikthyer për herë të dytë në garë dhe Ornela Bregu. Ajo ç'ka ra në sy në finale e madhe ishte mungesa e moderatorës bukurorë Amarda Toska, e cila për shkak të shtatzanisë së saj të konfirmuar nga vetë Ermal Mamaqi, nuk u bë pjesë e finales. Ai me anë të energjisë dhe batutave të tij arriti të krijonte një atmosferë mjaft të këndshme në spektakël duke e menaxhuar mjaft mirë atë. Sa i përket garës ajo u zhvillua në disa ruanë ku pati eliminime në bazë të pikëve të jurisë dhe publikut. Në përfundim të sfidës së parë, gjashtë finalistët kërcyen duke pasur si kolonë zanore këngët e tyre, të sjella në një version të ri në mënyrë që të përshateshin në disiplinën kërcimit që kishin. Të eliminuarit e parë ishin dy



finalistët, Foto Strakosha dhe Xhani Shqerra si më pak të votuarit. Katër çiftet e mbetura kaluan në sfidën e dytë, bazuar në kërcimin e tyre, të përzgjedhur si më i miri ndër 11 javët, e kësaj gare. Edhe pas kësaj sfide, u eliminuan si më pak të votuar dy çiftet, Zhaku dhe Ornela Bregu. Më pas dy çiftet finaliste të mbetura në garë ishin Vedat Ademi dhe Elvana Gjata, të cilët zgjodhën vetë kërcimet për njëri-tjetrin. Pas kërcimesh e sfidash misis konkurrentëve ishin juria dhe publiku të cilët dhanë verdiktin për fituesin e këtij edicioni të tretë të DWS, i cili përfundoi me fitoren e Elvanës. Megjithatë edhe në javën e fundit nuk mund të mungonin prapaskenat nga spektakli i yjeve. Në foto shohim Gerdin i cili është duke u udhëzuar finalistët për hapjen e spektaklit. Ata duken të gjithë të emocionuar ndërkohë që presin sinjalin për të nisur garën. Finalisti i renditit në vend të dytë, Vedat Ademi është fotografuar teksa është duke larë duart përpara fillimit të spektaklit. Ndërkohë që ndryshe nga herët e tjera moderatori Ermal Mamaqi, ka zgjedhur t'a memorizojë skenarin në natyrë. Gjithashtu edhe fituesja e DWS, Elvana Gjata, është duke u konsultuar me skenaristen Zefina Hasani përpara daljes në skenë. Elvanën e shohim të mbushur me bigudina. Në këto foto shohim edhe regjizorin Andy Gramin i cili duket pagjumë për shkak të punës intensive në Dancing. Ndërkohë që spektaklit i janë bashkuar edhe ish-konkurrentët Bujar Kapexhiu, Niada Saliasi dhe Artan Imami, të cilët janë fotografuar duke ndjekur finalen. Edhe për këtë sezon "Dancing With The Stars" përfundoi, megjithatë jemi në pritje të edicionit të katërt të këtij formati televiziv.



ERIK LLOSHI:

“Unë dhe muzika tashmë jemi një”

Djali i baladave flet për projektet e ardhshme muzikore

SUADA DACI

Edhe pse në fillimet e karrierës së tij, këngëtari Erik Lloshi ka arritur një sukses të konsiderueshëm si dhe është bërë mjaft i dashur për publikun. Lloshi është vlerësuar me çmimin “Best Pop” në Top Fest 9, me baladën “Ajo është ajo”. E ardhur nën siglën e “Threedots Production” kënga ka arritur të jetë një ndër më të klikuarat në YouTube, si dhe të rrëmbejë zemrën e shumë dëgjuesve femra. Erik Lloshi rrëfen në një intervistë për suplementin “THASH&THEM”, fillimet e karrierës së tij në muzikë, bashkëpunimet e ardhshme, aspiratat dhe emocionet në Top Fest. Gjithashtu djali i baladave, Erik Lloshi nuk lë pa përmendur edhe jetën e tij private ku shprehet për vajzën që i ka rrëmbyer zemrën.

Best Pop , në Top Fest, çdo të thotë ky çmim në karrierën tuaj muzikore?

Best pop është çmimi i parë për mua. Për çdo artist është shumë e rëndësishme kur puna intensive që,

është bërë për të realizuar një produksion të mirë vlerësohet, kjo do të thotë shumë për mua duke mos harruar që jam në fillimet e karrierës sime.

“Ajo është ajo”, kush është ajo , kujt i kushtohet kjo këngë?
Kjo është një pyetje që për publikun tashmë përgjigja është e njohur. “Ajo” është e dashura ime.

Një këngë që ka si autore Zhakun dhe është një prodhim i “Threedots Production”, si lindi ky bashkëpunim?

Kënga “Ajo është ajo” nuk është produksioni i parë që unë realizoj me “Threedots Production”, pasi bashkëpunimi me ta ka lindur nga kënga “Premtimi”. Duke njohur dhe më parë Kledi Bahitin kompozitorin e këngës, kërkoja një këngë dhe nga puna e tij rezultati ishte “Premtimi” që mendoj se mori suksesin e duhur.

Kënga ka kaluar në finale me votat e publikut, sipas jush çfarë ka të veçantë që është pëlqyer nga publiku?



Përgjigjen e kësaj pyetje besoj se më mirë e jep publiku, por mund të them që jam shumë i lumtur që u përfaqësova me këtë këngë.

Cilat janë projektet pas Top fest? Vera gjithmonë sjell projekte të reja dhe nga unë nuk do të mungojnë. Do jem i pranishëm në klube të ndryshme të Tiranës dhe Shqipërisë duke luajtur muzikë live me grupin tim.

Do të kemi përsëri një baladë?
Është muzika që më shoqëron



Mendoj se performancat live të rrisin shumë profesionalisht sepse një këngëtar i mirë është ai që di të përballoj muzikën live. Për mua është si një shkollë e dytë

Kush e zbuloi talentin tuaj për muzikën?

Talentin tim e kanë zbuluar prindërit e mi, që kur kam qenë fare i vogël, rreth moshës 5 vjeçare. Kam qenë mbështetja ime më e madhe në çdo hap timin dhe më kanë dhënë mbështetje dhe përkushtim të pakursyer.

Sa e doni muzikën?
Me muzikën jam “një”. Çdo gjë më lidh vetëm me të, duke qenë se është e profesionit im.

Përveç saj keni ndonjë hobi tjetër?
Më pëlqen shumë futbolli, e ushtror shpesh por nuk mund të them që jam një lojtar i mirë.

Dimë që jeni i lidhur, e dashura juaj është këngëtare?
Jo, profesioni i saj nuk ka lidhje me muzikën dhe artin.

Ndiheni të lumtur bashkë?
Sigurisht që po. Nuk mund ta konceptoj një lidhje, kur nuk ndihesh i lumtur me personin që ke në krahë.

Ju kemi parë që me bandën tuaj performoni live në shumë nga lokalitetet e kryeqytetit. Sa ju ka ndihmuar kjo gjë për të performuar live?

Po është e vërtetë. Mendoj se performancat live të rrisin shumë profesionalisht sepse një këngëtar i mirë është ai që di të përballoj muzikën live. Për mua është si një shkollë e dytë.



gjithmonë dhe më bën të ndihem mirë, pse jo...

Ju kemi parë të këndonit edhe në duet me këngëtares Mariza Ikonomi, në fakt do të ketë ndonjë bashkëpunim me këngëtarë të tjerë?

Realisht kam në plan për bashkëpunim, por nuk mund të them me shumë sepse nuk kam diçka konkrete.

Si e kujtoni bashkëpunimin me Marizën?

Ishte bashkëpunimi i parë për mua, prej të cilit fillova të bëhem dhe i njohur për publikun dhe sigurisht do të mbetet gjatë në kujtesën time.



Çdo të premtë Lounge Bar, me çmim 200L Lounge Drink,
Çdo të shtunë Karaoke Night me Kelly, Blerina dhe Graciela
Çdo ditë një menu e pasur me gatime shqiptare dhe italiane.
Çdo ditë Menu ofertë 500L-ku është e përfshirë një pjatë e parë, pjatë mishi ose gatime shtëpiaje, dhe një pjatë.
Catering të shpejtë në shtëpinë tuaj

**RRUGA "MUSTAFA MATOHITI",
PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA**
Cel. 0696070651

DANCING WITH THE STARS

Flasin 4 finalistët: "Fitorja e Elvanës e merituar"

Pas përfundimit të DWS dhe shpalljes fituese të Elvana Gjatës konkurrentët finalistë të spektaklit janë shprehur pozitivisht për fitoren e saj. Fituesi i vendit të dytë Vedat Ademi, ka thënë se kjo eksperiencë do të mbahet mend gjatë prej tij, por ishte

publiku ai që vendosi. Ndërsa Foto Strakosha i cilëson të dy si fitues duke mos ndarë asnjërin prej tyre. Ndërsa Zhaku në faqen e saj zyrtare në Facebook ka falenderuar fansat e saj për mbështetjen duke premtuar se shumë shpejt do të dalë në treq albumi i saj muzikor.



VEDAT ADEMI



Nuk u mërzi ta aspak. Në fakt nuk jam mërzi- i tur asnjëherë kur nuk kam fituar sepse në karrierën time artistike, unë kam fituar një gjë shumë të madhe dhe ai është publiku. Për mua kjo ishte një eksperiencë e jashtëzakonshme që do ta mbaj mend gjatë dhe më vjen mirë që dola si burrat nga kjo garë. Në fund të fundit është publiku ai që vendos.

ZHAKU

Faleminderit shumë për dashurinë që më keni dhënë dhe për votat gjithashtu. Faleminderit për mbështetjen dhe fjalët e mira. Kjo më duket si ringjallja e Krishtit :) Por tani me këtë ringjallje të dashurisë dhe komunikimit mes meje dhe jush nuk duhet të ketë më fund. Së shpejti unë dhe partneri im në jetë dhe muzikë do publikojmë albumin tonë dhe do të zhvillojmë edhe koncerte, të cilat do mund të jenë edhe pika takimi mes nesh miq të dashur. Ju falenderoj shumë dhe ju dua shumë.



KHANI SHQERRA

Mbërritja në finale për mua ishte një sukses më vete. Ky rrugëtim në këtë edicion ka qenë me tatëpjeta dhe mund të them me bindje të plotë që ka qenë një pasqyrim i gjithë jetës sime artistike dhe private i bazuar në emocione autentike, në pasion, talent dhe vullnet në punë. Të jem i singërtë e prisja që të ishte Elvana fituese, por për konkretizimin e familjes që Vedati po pret do të dëshiroja që çmimin material ta fitonte ai. Ndërsa kupën e meritonin të dy derisa të dy arritën në finale. Po sigurisht që Elvana e meritonte të ishte fituese, sepse na nderoi të gjithëve.



FOTO STRAKOSHA



Ishte një eksperiencë që nuk e dija as vet që do të merrja pjesë në të. Ndiem shumë i lumtur sepse kam dal shumë i kënaqur nga ky spektakël. Ishte një eksperiencë që nuk e dija as vet që do të merrja pjesë në të. Ndiem shumë i lumtur sepse kam dal shumë i kënaqur nga ky spektakël.

CANA & DESTANI

Shokë të pandarë

Dy personazhet e famshëm nga Kosova aktori Blerim Destani dhe futbollisti Lorik Cana, janë fotografuar së bashku. Dy meshkujt simpatikë kanë qenë të pranishëm në një festë në Kosovë, ku kanë bërë edhe foto së bashku.

Kapiteni i kombëtares shqiptare, Cana ka veshur një T-shirt lella dhe është duke konsumuar një pije ndërkohë që Destani po tymos një puro. Bashkë me dy yjet kosovarë ka qenë edhe fituesi i Big Brother Albania, Arbër Zeka.



ARDIAN BUJUPI

Së shpejti në duet me Nogën

Ardian Bujupi, pop ylli shqiptar me famë botërore, duket se ka filluar të bashkëpunojë me artistët nga Kosova. Tinejxheri nga Prishtina, Noga, ka bërë të ditur në profilin e tij në Facebook me një video të shkurtër se ai është takuar me Ardian Bujupin dhe se kanë filluar të punojnë në realizimin e këngës që do të titullohet "Tonight". Noga, i cili sapo ka mbushur 18 vjeç, ka bërë të ditur po ashtu se është duke xhiruar një videoklip në vlerë 50 mijë euro për këngën me Dr. Florin, "Na Kalle", e cila pas pak ditësh pritet të lançohet në kanalën e tij, që ka jo më pak se 12 milionë klikime.



SHEILA HAXHIRAJ:

Unë një produkt 100 % i X-Factor

Shumë shpejt një hit i ri veror

SUADA DACI

Pas një rrugëtimi të gjatë muzikor, 18 -vjeçarja nga Tirana, Sheila Haxhiraj arrin të triumfojë në spektaklin e talenteve X-Factor Albania, duke u shpallur fituesja e vendit të parë. Nën monitorimin dhe kujdesin e mentores së Juliana Pasha, Haxhiraj arriti të shkëlqejë duke shpalosur kështu vlerat e saj muzikore. Sheila rrefen për suplementin "THASH&THEM" emocionet e fitores, dëshirat dhe planet e saj prej maturanteje. Megjithatë vajza nga Tirana nuk është pronuar në lidhje me historinë e përfolur në media për të dhe reperin Noizy. Përveç fitores të edicionit të parë të X-Factor Albania, Sheila do të nënshkruajë një kontratë me producentët e "Berman Brothers", të cilët kanë promovuar shumë talente të muzikës.

Sheila si ndiheni tani që jeni ju fituese e X-Factor Albania?

Shumë e lumtur, po e shijoj pafundësisht këtë fitore, që është një shans i madh për të më hapur mua rrugën drejt një karriere të suksesshme (shpresoj).

Si ka ndryshuar jeta juaj pas X Factor?

Tanimë nuk jam thjesht Sheila Haxhiraj, një vajzë maturante, por njerëzit më njohin si Sheila fituese e X-Factor. Më urojnë dhe më komplimentojnë dhe kjo gjë natyrisht që më bën të ndihem e lumtur.

Do të keni angazhime të tjera muzikore, tani me mbarrimin e këtij spektakli?

Padyshim që po, kam shumë plane dhe shpresoj ti realizoj.

Si ka nisur lidhja juaj me muzikën?

Unë nuk kam studiuar kur-



rë muzikë, ajo ç'ka unë dhashë në skenën e X-Factor ishte falë talentit dhe pasonit tim për të punuar dhe sigurisht falë ndihmës së madhe të mentores time, Juliana Pasha, pra unë isha thjesht një produkt 100% i X-Factorit.

Jeni shprehur gjithnjë e sigurt që do të arrinit në finale ishit e bindur sepse e ndjenit që ishit në nivelin e duhur, apo më lart se konkurrentët e tjerë të X-Factor?

Absolutisht nuk kam shprehur ndonjëherë siguri maksimale se do të arrija në finale. Unë i vlerësoj të 16 finalistët dhe së bashku me ta kam ndjerë të njëjtat emocione si ata, ankth, "frikë" dhe lumturë, por besoja dhe shpresoja shumë në punën time korrekte, të palodhur dhe në ambicijen time për të qenë në finale. (Fati ishte me mua). (qesh)

Cili ka qenë momenti më i bukur në X-Factor?

Natyrisht momenti më i bukur në X-Factor ka qenë momenti, kur unë u kurorëzova si fituese e edicionit të parë shqiptar të këtij ko-

Ndihem e vlerësuar dhe e lumtur që kam performuar në duet me mentoren time Juliana Pashën

mpeticion.

Si do ta cilësonit marrëdhënien me mentoren tuaj, Juliana Pasha?

Juliana Pasha për mua përveçse një profesioniste, mësuese, ka qenë edhe një shoqe shumë e mirë, e cila më ka ndihmuar dhe më ka qëndruar pranë edhe në momente të vështira, mërzitjeje,



Sheila feston me Noizyn fitoren



Pas përfundimit të X-Factor dhe shpalljes fituese të këtij edicioni të Sheila Haxhiraj, ajo është fotografuar duke festuar suksesin e saj. Në këtë foto Sheila ndodhet në një tavolinë me reperin Noizy si dhe me të ftuarin special në këtë spektakël këngëtarin nga Kosova, i cili prej vitesh jeton në Gjermani,

Adrian Bujupi. Në media është përfolur për një histori mes reperit dhe 18-vjeçares, por Sheila nuk ka pranuar të prononohet. Nuk dihet ende cila është marrëdhënia e tyre por diçka dihet me siguri, që Noizy ka qenë i pranishëm natën e finales së X-Factor ku ka festuar fitoren e Sheilës.

etj. Ajo është për mua një këshilluese dhe një njeri me vlera dhe sigurisht me shpirt të madh.

Sa ju ka ndihmuar Juliana në këtë kompeticion?

Për të katërta vajzat Juliana ka qenë një mësuese pasionante dhe e pa lodhur, që na ka mësuar me shpirt gjithçka. Mendoj që për këtë arsye kategorija e vajzave ka qëndruar më gjatë në skenën e X-Factor dhe ka bërë prezantim dinjitoz, derisa e gjithë kjo punë

dëshira jonë e përbashkët për të zgjedhur një këngë të vështirë të dy divave të muzikës botërore, Beyonce dhe Tina Turner, për të bërë kështu një prezantim dinjitoz në natën finale dhe mendoj që i'a arritëm.

A keni një këngëtar të preferuar?

Beyonce dhe Jessie J janë këngëtares e mia të preferuara. Më pëlqejnë për vokalin dhe performancën e tyre.

Si ndiheni tani që jeni bërë një person publik? Ju njohin më shumë njerëzit?

Të qenit person publik padyshim që të bën të ndihesh e lumtur . Sidomos në rastet kur merr komplimenta dhe urime nga njerëz të ndryshëm. Por gjithashtu mendoj se, fakti i të qenit në vëmendje të njerëzve të vë në siklet, pasi gjatë gjithë kohës duhet të jesh e kontrolluar.

Cilat janë angazhimet e tjera të Sheilës?

Së pari jam e angazhuar me provimet e maturës dhe më duhet të mendoj për studimet e larta. Por nuk do t'i lë pas dore planet e mia në fushën e muzikës, ndoshta për të bërë një hit veror .

SHKOLLA E PARUKERISË - ESTETIKËS

KRËHËRI I ARTË (LUÇI)

Adresa: Rr. Mihal Grameno, 200m mbi Shkollën e Baletit
Tel: 04 2 233 950
Facebook: Kreheri i Arte Tirane

Kurse 6 - 9muajore.
Për më të mirët mundësi punësimi Regjistrimi vazhdon

ROZANA RADI

“Besoj tek drejtësia, jam e pafajshme”

Pas pretendës së dhënë nga Prokuroria për shpalljen fajtores të këngëtares Rezarta Shkurta, për sherrin midis saj dhe Rozana Radit, kjo e fundit shprehet në një prononcim për “THASH&THEM”, se beson tek drejtësia shqiptare. “Besoj se Prokuroria ka qenë e saktë në pretendën e dhënë. Unë jam në pritje të gjyqit që do të zhvillohet së shpejti. Besoj tek drejtësia shqiptare pasi jam e pafajshme”, është shprehur Rozi. Sipas prokurorit të çështjes Rezarta Shkurta duhet të shpallet fajtores për rrahjen e Radit si dhe të kryejë 82 orë punë të detyrueshme në Bashkinë e Tiranës. Mosmarrëveshjet midis dy këngëtareve kanë lindur që pas pjesëmarrjes në reality show “Vip Shtëpia” dhe më pas kanë denigruar deri në konfrontime fizike mes tyre.



LINDA HALIMI

Së shpejti në duet me Leonora Poloskën

Këngëtarja, Linda Halimi ka thënë se shpejti do të sjell një këngë të re me kologen e saj, Leonora Poloska. Halimi e ka bërë të ditur lajmin në rrjetin social Facebook. “Po e zbuloj një surprizë për të gjithë fansat. Jam shumë shumë e lumtur që më në fund po realizoj duetin, që kam ëndërruar gjithmonë me vokalin me të mirë shqiptar, Diva Leonora Poloska, idhullin tim! Kënga do të realizohet nga ne të dyja, dhe orkestrimin do ta bëjë producenti, që më së miri ka ditur të punojë me mua, i madhi Florent Boshnjaku!”, ka shkruar Halimi. Kohët e fundit ajo po menaxhon një qendër dobësimi.



GARA

Rally Albania drejt përfundimit

Gara spektakolare e Rally Albania 2012 është drejt fundit. Garuesit po i afrohen Tiranës e cila pritet të jetë edhe etapa përfundimtare e kësaj gare. Edhe këtë vit kjo garë ka falur emocione të shumta. Megjith-

atë nuk janë përjashtuar dhe aksidentet të cilat kanë shënuar disa të plagosur. Edicioni i 8-të i Rally Albania startoi më datë 9 qershor. Piramida ishte pikënisja e garësve të cilët do të përshkrijnë me automjetet e tyre thuhet 80% të territorit shqiptar, në një javë emocionuese që ka mbledhur rreth 320 pilotët nga 22 shtete të botës. Ata përshkruan rreth 80 përqind të territorit shqiptar në një javë, duke filluar nga Razma në Theth, nga Voskopoja në Himarë, e duke u rikthyer përsëri në Tiranë.



BIG BROTHER 5

Ikën Evelin tërbohët Liami

Ish-konkurenti i Big Brother Albania, Armando Osmani i njohur si Liam, është fotografuar në klube të ndryshme nate, jo vetëm në kryeqytet por edhe në Vlorë, e Korçë në prani të shumë femrave. Konkurenti i cili prej vitesh jeton në Gjermani, ka një lidhje me vajzën gjermane, Evelin Pollok me të cilën do të martohet së shpejti. Por sapo Evelin është larguar për në Gjermani, Liami nuk ka ngurruar të dalë dhe të shfaqet në klubet e natës, jo vetëm si DJ por edhe si klient. Ai është fotografuar mes shumë vajzave duke kërcyer për qejf të tij. Urojme që Evelin të mos bëhet xhelozë për të dashurin e saj simpatik.



ALBUMI

Dilemat e Tunës

Derisa kanë mbetur edhe pak ditë nga lançimi i videos më të re të këngëtares Altuna Sejdiu, ajo ka filluar punën në diçka tjetër. Këngëtarja shkupjane këto ditë po punon në finalizimin e albumit të ri, prandaj ajo ka kërkuar ndihmën e fansave të saj rreth titullit që do të mbajë albumi. “Si ta titullojmë albumin, jemi në dilemë të madhe...Dërgoni ndonjë propozim”, ka shënuar Tuna në rrjetin social Facebook, ndërsa ky status ka marrë me dhjetëra komente me propozime. Ndërkohë, kënga që do të shoqërohet me klip titullohet “I asaj” dhe pritet të shfaqet së shpejti. Në bazë të disa fotografive të publikuara, duket se Tuna ka vendosur edhe këtë herë të eksperimentojë me dukjen e saj.





Festivali

■ ■ ■ TIRANE

DHURATA HAMZAI

"POETIKA"

Si u shua tradita

Arian Leka: Largimi nga misioni fillestar i festivalit



Arian Leka

Nisi në Durrës në vitin 2004 si një nga traditat më të mira të festivaleve në Shqipëri. Nuk i munguan poetët nga Shqipëria, as ftesat nga vendet e huaja. Çmimi i parë i festivalit mbante emrin "Unaza Poeteka". Festivali ndërkombehtar i poezisë u zhvillua me sukses deri në edicionin e gjashtë me një program të pasur, ku media, autorë, vizitorë dhe turistë i jepnin qytetit turistik një pamje festive. Në këtë festival vunë "Unazën" e trofeve poetë të kalibrit si Maria Lusica Spaziani (Itali) në 2006-n, Casimiro De Brito nga Portugalia. Ai është i dyti pas Pessoa-s. Erdhën Claudia Keelan dhe shkrimtari i njohur Hart VVegner nga SHBA, poetja Fiona Sampson nga Anglia, etj. Në të shtatën edicion festivali e prishi traditën. Ministria e Kulturës (MKRS) nuk dha fonde. Nuk erdhën më poetë. Durrësi mbeti pa festival. Fama e tij u zbeh dhe një vit më parë ai u izolua në mjediset e Teatrit të Metropolit të Tiranës me lexime letrare. Këtë traditë nuk e prishi drejtori Arian Leka, i cili pasi e humbi betejën për ta ruajtur festivalin në atë lartësi që e ngjiti me aq mundim, nuk gjeti një rrugë më të mirë, veç përpjekjes për të mbajtur gjallë frymën akademike. Kur e pyet, jep një përgjigje tepër retorike për fatin e "Poeteka"-s. Na bëjnë të kuptojmë që ta lëmë të qetë, siç do bënte çdo humbës betejash të lavdishme...

PSE E HUMBI FESTIVALI TRADITËN?

Ministria e Kulturës nuk dha fondet. Që prej dy vjetësh ku institucion ka shkatërruar të gjitha festivalet e traditës. MKRS nisi të prishte me radhë të gjitha traditat e festivaleve, të festivalit të poezisë në fillim, të teatrit, "Butrintin", më pas, të festivalit të filmit me metrazh të shkurtër, etj. Edhe pse nën Neni 26. pika 1-a, citoen përgjegjësinë e saj për festivalet, këto po shuhen. "Poeteka" ka hyrë në edicionin e tetë, pa e ndërprerë veprimtarinë e saj, por nuk është më një festival poezie i atyre përmasave. Ka një program aktivitetesh të bukura dhe me frymë sociale, duke mbijetuar nga përkrahja e AMSHC-së, Agjencisë për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile që jep Asistencë Financiare "për nisja qytetare në të mirë dhe interes të publikut". Por a ishte misioni i "Poeteka"-s dikur... vetëm një gjest "në të mirë dhe interes të publikut". Drejtori i këtij festivali, thotë variantin e tij në intervistën për Shqiptarja.com

Arian, si e keni filluar festivalin "Poeteka" sivjet?

"Poeteka" ka filluar që në muajin shkurt. Projekti do të zgjasë 14 muaj. Mbrojtja është prej AMSHC-së. Sot kishim një aktivitet në auditoriumin e Qendrës së Formimit Policor: "Përkthimi - Gjithçka përkthehet... Gjithçka është përkthim...!". Profesor Edmond

Tupja shpjegoi edhe fjalën status. Secili prej nesh është në një status të caktuar të cilin e braktis për një status të ri. Ky status mund të jetë

një status poetik, jopoetik, mund të jetë social, joprofesional dhe në këtu kemi menduar që "Poeteka" të hyjë si ndërmjetës midis statusit

Një ditë nga "Poeteka 2012"

"Përkthimi" në bankat e Akademisë së Policisë

Organizatorët e festivalit "Poeteka" ishin në auditoriumin e Qendrës së Formimit Policor (Sauk, Tirane. Vepimtaria përmbante një ligjëratë, bashkëbisedim dhe ilustrime rreth kontekstit ndërkulturor dhe social të "përkthimit" si term i hapur dhe domethëniesve të tij në shoqëritë post-totalitare dhe ato të komunikimit masiv". Tema ishte: "Përkthimi - Gjithçka përkthehet... Gjithçka është përkthim...!". I ftuar ishte profesor Edmond Tupja dhe moderator Arian Leka.



Ç'domethënie ka koncepti "të përkthesh"? A shpreh ky koncept të njëjtën gjë kur kalon nga njëra shoqëri në tjetrën, nga njëra kulturë në tjetrën: çfarë mund të përkthejmë dhe ç'mbetet pa përkthyer në një komunikim brenda së njëjtës shoqëri dhe a mund t'i përkthejmë, për t'i bërë tonat, konceptet apo modelet e shoqërive të tjera? Përkthehet vetëm fjala apo tashmë gjithçka përkthehet dhe gjithçka është shndërruar në përkthim? Organizatorët duke qenë se edhe mjetet e tjera sot përfillen si "gjuhë" ndërkommunikimi, kana trajtuar problemet si mund ta përshtatim dhe ta përkthejmë gjuhën, komunikimin, apo mënyrat sjelljes dhe të paraqitjes sa herë që vihem përballë komunitetit. Gjithashtu në auditoriumin e trajtues në kudër të "Poeteka 2000" edhe procesi i ndërmjetësimit, negocimit dhe interpretimit të këtyre mjeteve shprehëse, përkthyer si metagjuhë komunikimi, si dhe roli i kulturës në këtë komunikim. Një nga problemet më të mprehta është abuzimi kur përkthehet me Google Translate. "Unë 40 x më shumë të mi ua ktheva detyrat, përkthehet, sepse i kishin bërë me Google Translate", tha profesor Tupja, i cili bëri një paraqitje në rrafsh shkencor mbi praktikën dhe teorinë e përkthimit.

MINISTRIA E KULTURËS: Festivali i poezisë humbet traditën. MTKRS për dy vjet rresht nuk dha fondet. Drejtori i festivalit rrëfen pse e braktisi Durrësin "Poeteka"?

aktual, statusit në kërkim midis botës së lektorëve. "Poeteka" do t'i vejë në dispozicion të komuniteteve të ndryshme ku do të ketë poezi, leksione si ky i sotmi, përkujtime, promovime të revistës me numrin e vet, poezi tematike siç ishte rasti i kolonës së "Ballkanit" që ne përurojmë pas pak ditësh, pas javës që vjen.

Fati i festivalit "Poeteka" vitet e fundit ka ndryshuar fushën e spektaklit, nga vepërmataria me poetët në Durrës shtyhet nëpër shkollat dhe auditorët?

"Nuk është ky qëllimi i ndryshimit të "Poeteka"-s. Besoj se shtatë edicione ishin më se të mjaftueshme për të shteruar të gjithë skenën poetike të produktit vendas dhe ftesës. Tani jam për një komunikim më ndryshe të poezisë në vetvete, por të poezisë dhe poetit si një instrument shoqëror të poezisë, si një mënyrë jetese. Synimi është për ta bërë poezinë një lloj besimi, jo për ta bërë poezinë një lloj kulti, ngaqë hyjnë vetëm ata që dinë, vetëm ata që njohin rregullat. Nuk ka të bëjë me strukturime që ndoshta ju i kishit në pyetjen tuaj. Ka të bëjë më projektionin e ri...

Duke trajtuar përkthimet në këtë edicion, a është koha që ato të kenë një status?

"Ne zgjedhëm një grup, të cilët ndoshta nuk janë konsumatorët direkt të përkthimit letrar, por ata janë njerëzit që vihen përballë përkthimit shoqëror, janë ata që duhet të përkthejnë shoqërinë. Ata janë të ekspozuar ndaj përkthimit shoqëror. Menduan se ky është momenti që duhet ndërhyrë me një mesazh si ky i sotmi sesi duhet të përkthejmë gjuhën e njëri tjetrit, si duhet të futemi në gjuhën e njëri tjetrit dhe kjo është pikërisht mojtja që kemi zgjedhur.

Përdorja e Google Translate, futur në tekstet letrare dhe akademike, çfarë pasojash sjell?

"U shpreh në këtë aktivitet. Ne jemi në një auditorium i cili e përdor fsheshtas përkthimin automatik. Është një lloj i përkthimit pa praninë njerëzore, i përkthimit dinak përmes një instrumenti i cili zotëron një fjalor, por nuk ka një ndeshmëri. Zotëron të gjithë inventarin e fjalëve, madje më shumë sesa kujtesa njerëzore, por nuk është i zotë i organizojë dhe t'u japë shpirt këtyre fjalëve. Është mënyra më e pashpirt që mund t'i afrosh një njeriu; të përkthesh me Google Translate.

Po problemet e përkthimit të letërsisë si qëndrojnë?

"Përdorja e Google Translate në përkthimin punë dhe e kemi zveshur nga misionet, që këtu fillon një problematikë e mëdha. Përkthimi nuk shihet si mision, se çfarë të marrim prej përvojës letrare dhe jo letrare të teksteve për t'ia sjellë kulturës sonë dhe çfarë kemi për t'u dhënë teksteve të tjera.

Gjovalin Paci
"Jetë e humbun" ekspozohet në rrënojat e burgjeve



Një vepër nga cikli i pikturave "Jetë e humbun"

Piktori i njohur Gjovalin Paci pas ekspozimit në Kuvendin e Shqipërisë të 100 pikturave të frymëzuara nga libri "Jetë e humbun" e Ejell Cobës nis një udhëtim të ri. Ai ka pohuar për "Shqiptarja.com" se do ta çojë ekspozitën në ish-kamperet e të burgosurve politikë ku fillohet me Burrelin, me Spacën dhe do të shkojë deri në Orosh, një nga zonat më të persekutuar të zonës së Mirditës. Ekspozita do të udhëtojë në një cikël treditëror në këto vende, pasi i ka kryer udhëtimet e para të saj nga Tirana, në Durrës dhe në Shkodër. Nuk do të jetë i thjeshtë ky lloj prezantimi për pikturin. "Në ato vende nuk ka mure ku të varen pikturat, por do t'i prezantojmë me mjete rrethore, me kavaletë, tela, etj" tha piktori. Ndërsa rrëfen se në

Shkodër kjo ekspozitë pati shumë vizitorë, sepse shkollat e gjene veteveten aty, Paçi thotë se piktura trajton një temë delikate. Autori i librit prej të cilit ka mishëruar veprat ka vizatuar me gjuhën e rrëfimit personalizuar të njohur nëpër

burgje. Interesi i pikturit në këtë udhëtim është vetëm emocional. "Dua t'i shkel ato vende, jo në galeri në ato kushte që është burgu në rrënoja. Ai do të përshatet me terrenin dhe vendin e ekspozimit. Ato vende janë të zbrazëta, por dy komunat e Spacës dhe Oroshit kanë bërë organizimin, ndërsa piktori thotë "do të jenë ekspozita tre orëshe në natyrë të hapur dhe për çdo ditë në një turne treditëror do të udhëtojë gjithë cikli i ekspozitës".



POLONIA PËR JETË A VDEKJE

Sot do të zhvillohen ndeshjet e fundit në grupin A. Dy sfidat e këtij grupi janë Republika Çeke-Poloni dhe Greqi-Rusi. Polonia do të kërkojë fitoren me çdo kusht, pasi barazimi e nxjerr jashtë. Shpresat janë te dyshja Levandovski-Polanski. Ndërsa Çekisë i mjafton edhe barazimi për të kaluar më tej. Ndeshja pritet të jetë tepër emocionuese dhe të dhurojë spektakël.



RUSIA KËRKON VENDIN E PARË

Greqia do të luajë ndeshjen e fundit në finalen e kompeticionit me Rusinë në orën 20:45 në stadiumin e Varshavës. Pas dy ndeshjeve të para, helenëve nuk ju mbetet gjë tjetër veçse të përshëndeten me Europeanin. Ndryshe nga Rusia që tregoi se është një ekip rivalizues dhe i vështirë për t'u thyer. Sot rusët do të kërkojë fitoren për të kaluar në vendin e parë në grup.

Franca dhe Anglia kryesojnë grupin D

Anglia dhuron spektakël Franca s'ndalet

Ukraina gjithçka për ndeshjen e fundit

Lajmi

Me dy ndeshjet e sotme të grupit D ka përfunduar edhe xhiron e dytë e ndeshjeve në grupe. Franca ka mundur Ukrainën me rezultatin 2-0 në shtëpi, po ashtu edhe Anglia ka fituar me Suedinë me rezultatin 3-2 duke ju bashkangjitur Francës në krye të grupit D me nga 4 pikë.



FRANCE-UKRAINË 2-0

Shënues: 52' Menez, 55' Cabaye

ANGLI-SUEDI 3-2

Shënues: 23' Carroll, 64' Walcott, 78' Welbeck, / 49' Jonson(out) 59' Mellberg

TIRANE

DYLBËR BALLA

Franca ka arritur një fitore mjaft të rëndësishme për objektivat përballë Ukrainës me rezultatin 2-0 duke u ngjitur në krye të grupit D. Ndeshja ka qënë e mbushur me shumë të papritura pas rreshtit të shiut që ka përfshirë stadiumin e Gdanskit, madje duke e pezulluar lojën një 60 minuta. Gjithçka ka nisur ashtu sikur ishte planifikuar në orën 18:00, por vetëm pas minuta pas startit, ka ardhur edhe vërshëllima e arbitrit për ndërprerjen e sfidës, pasi fusha u kthye në vaterpolo nga rreshtet e dendura të shiut. Pas 30 minutash, UEFA ka vendosur që ndeshja të rifillonte në orën 19:00 duke llogaritur edhe pesë minutat e zhvilluara. Dhe kështu ka ndodhur, ekipet kanë zbritur në fushë për të vazhduar misionin. Edhe pse e karakterizuar nga një lojë e vullshme dhe me shumë raste, pjesa e para ka përfunduar

SULMUESI

Runi kthehet me Ukrainën



Pas dy ndeshjeve të para pa shumë futbollistë në fushë, trajneri Roy Hodgson në ndeshjen e fundit në grup me Ukrainën do të ketë edhe një armë më shumë. Uein Rony ka shlyer dënimin e vendosur nga Uefa për dy ndeshjet e para të kampionatit European dhe do rikthehet në fushë përballë Ukrainës. Ndeshja e fundit shihet si finale për "Tre Lunët" pasi kush do të humbasë do të bëjë valixhet gatë për tu larguar. Rony do të jetë një garanci shumë e madhe e anglezëve për të kaluar në çerekfinale.

me rrjeta të paprekura. Në të dytën Franca kërkon me ngulm golin me Nasrin dhe Benzemanë, por e gjen me Menezin me një gjuajtje të bukur duke mposhtur portierin në minutën e 53', pas dy

minutash "gjelat" kanë vultur rezultatit duke shënuar edhe golin e dytë me autorë Cabaye duke treguar supermaci në fushë përballë vendasve. E lodhur nga shiu dhe nga qarkullimi i topit të

kundërshtarit, Ukraina e ka pranuar humbjen duke menduar për ndeshjen e fundit me Anglinë që do të jetë decisive për ecurinë në fazën e grupeve. Ndeshja tjetër e grupit në 20:45 Angli-Suedi ka dhuruar një spektakël të vërtetë nga të dy ekipet, por në fund Suedia ka humbur të gjitha mundësitë për të kaluar në çerekfinale pas dy humbjeve. Ndërsa anglezët ka realizuar një fitore të madhe me tre gola perfekte që e ngjisin në krye të rënditjes sëbashku me Francën me nga katër pikë secila. Ndeshja ka qënë mjaft emocionuese me gola dhe autogola. Fillimisht ka qënë Anglia që ka kaluar në epërsi në minutën e 23' me Andy Carroll me një gjuajtje të fuqishme me kokë brenda në zonë duke e mbyllur pjesën e parë me fitore. Por në të dytën barazon përsëri një lojtar anglez, Jonson me një autogol. Barazimi ka rritur entuziazmin te Suedia që ka kaluar në avantazh me Mellberg në minutën e 59', por Suedia ka treguar edhe njëherë që nuk është e aftë të mbrojë avantazhin duke përsëritur ndeshjen me

Ukrainën. "Tre Lunët" të hedhur të gjithë në sulm barazojnë me Walcott në të 64' duke sflitur suedezët. Në fund rradhën e ka pasur Welbeck që ka shënuar një eurogol me finte, ndoshta më të bukurin deri

në finalen e kompeticionit. Në ndeshjen e fundit Anglia do të ketë një sfidë shumë të vështirë me Ukrainën, kush do të fitojë midis tyre do të kalojë grupin, barazimi shkon në favorin e Anglisë pasi ka një pikë më shumë.

Parashikimi

Elefanti frikëson Poloninë

Elefanti Çita me parashikimin e tij ka frikësuar të gjithë tifozët polakë. Sipas tij ndeshja e fundit në grupin A Republika Çeke-Poloni do të përfundojë në barazim ose do të fitojë Çekia, fitorja e polakëve nuk parashikohet. Çita në momentin që është vënë para zgjedhjes së mollëve midis 1/X/2 fillimisht ka preferuar "X", më pas "2", ndërsa "1" nuk është preferuar.



Kancelarja

Merkel, tifoza speciale

Kancelarja Gjermane Angela Merkel ka treguar edhe njëherë se është tifozja speciale e ekipit përfaqësues gjerman. Në ndeshjen me Hollandën, të cilën Gjermani e ka fituar me rezultatin 2-1 Angela Merkel është shfaqur duke festuar në entuziazëm fitoren. Merkel ndeshjen e ka ndjekur me disa nga miqtë dhe kolegët e saj.




Moti i keq

Të gjithë nën shi për Ukrainën

Shiu në ndeshjen midis Francës dhe Ukrainës e ka ndërprerë ndeshjen për afro 60 minuta, por nuk ka ndërpre festën e tifozëve të ekipit vendas të cilët në arenën e stadiumit të Gdanskit kanë dhuruar spektakël me paraqitjen e tyre. Femrat eveshura me ngjyrat e flamurit dhe me pankarta kanë mbështetur përfaqësuesen e tyre për rreth tre orë në fushë nën reshjet e shiut.





ZBAVITJE

[SHQIPTARJA.com] nditëse

Shkon në gjyq me makinën e vjedhur

Një amerikan nga San Francisco, emri i të cilit nuk bëhet i ditur, por thuhet se është me profesion parukier dhe është 37-veç, u ndalua nga policia lokale ndërsa po shkonte për t'u paraqitur në një proces gjyqësor kundër tij, ku akuzohej për vjedhje makine. Vëmendjen e policisë e tëhoqi fakti se personi në fjalë, i akuzuar për vjedhje makinash, parkoi pikërisht para gjykatës që atmet fuoristrada SUV të markës Lexus. Jo vetëm kaq, por kur u afruan agjentët e policisë panë se ai kishte lënë edhe çelësat e makinës në kuadër, atëherë menduan se ishte rasti për të bërë një kontroll. Dhe vërtet nuk ishin gabuar sepse nga të dhënat rezultoi se makina luksoze ishte vjedhur vetëm pak kohë më parë. E ndërsa shkuan për t'i vënë prangat, gjykatë e kishte dënuar tashmë për vjedhjen e një Porsche Carrera me një vlerë prej rreth 130 mijë dollarësh.



Ngatërron lumin me parkingun

Që njeriu kur është disi çakërcej nga alkooli të mos mbajë mend gjë kjo është normale, port të marrësh shtratin e lumit për parking, nuk është më fjala për çakërcej, por xurxull. Kështu i ka ndodhur pak kohë më parë një farë Peter Thaler, nga qyteti i vogël Sins në Zvicër, të cilin, ngaqë që bërë xurxull fare, shtratin e lumit e mori për një platformë tipike parkingu nëntokësor. Kështu, ca nga mjegulla që kishte rënë e ca nga avujt e alkoolit që ia kishin bërë mendjen lëmsh, i bindur se kishte parkuar në vendin e duhur, Peter e mbylli makinën dhe u kthye në shtëpi. Të nesërmen në mëngjes patrulla e policisë, duke menduar se makina kishte pësuar aksident dhe kishte rënë buzë lumit, u afrua, por kur panë se makina që e mbyllur e s'kishte asnjë shenjë aksidenti, kërkuan të dhëna nga qendra. Njëpërmyet të dhëna shkuan në shtëpinë e shoferit, i cili, megjithëse kishin kaluar disa orë ishte akoma si i shastisur. I këputën një gjobë të mirë dhe i hoqën patentën për disa muaj.



Betohet se ka pirë vetëm dy... pizza

Natyrish që kur të ndalon policia në kundërvajtje, gjëja e parë që të bie në mend është justifikimi për këtë ose për atë arsye. Por nganjëherë duke kërkuar të justifikohesh lëshon broçkulla të tilla që e rëndojnë më shumë pozicionin në të cilin ndodhesh. Kështu i ndodhi para pak kohësh një farë Donn Adams, i cili me makinën e tij kishte përfunduar jashtë ruge dhe kur mbërriti policia e Louisville ishte në një gjendje konfuz. Fillimisht policët kuptuan se ishte në atë gjendje për shkak të pronditjes nga aksidenti, por kur i bënë disa pyetje routine, e kuptuan menjëherë se ai ishte tapë. Në fakt pyetjes së agjentëve se a kishte pirë apo jo, ai përgjigjej duke bërë be e rufe se kishte pirë vetëm... dy pizza. Kaq iu desh policëve të kupton pa i vënë etilometrin si ishte nën efektin e alkoolit dhe, pasi i gjetën edhe një shiringë droge i vunë prangat edhe për mbajtje lëndësh narkotike



HOROSKOPI

- Dashi** Do të vazhdojë edhe sot një mbështetje thuajse gjatë gjithë ditës nga ana e yjeve të mirë, gjë që do t'ju japë mundësinë për të arritur objektiva shumë të rëndësishme. Më të hapur ndaj partnerit.
- Demi** Edhe pse jeni të favorizuarit e yjeve, Marsi ka është sërish në një orbitë negative dhe mund t'ju punojë ndonjë "trëng". Afërdita sërish në orbitë shumë favorizuese për sektorin e zemrës.
- Binjakët** Është një periudhë shumë e koklavitur kjo në të cilën ndodhen tani dhe kërkohet që të jeni shumë të vëmendshëm në hapat që do të hidhni apo vendimet që do të merrni. Intensiv aktiviteti.
- Gaforja** Edhe sot mund të jeni "të preferuarit" e shumë yjeve, prandaj pritjet të një ditë mjaft interesante në aspektin profesional. Hëna favorizon kontaktet në fushën sentimentale, por ju bën nostalgjikë.
- Luani** Mund të jeni ju "viktimal" e një Marsi shumë "agresiv" në shenjë, i cili "do t'ju fusë shkopi në rrota" në të gjitha tentativat tuaja për të konkluduar një marrëveshje. Humori është me hope.
- Virgjëresha** Sot do të jetë sërish Sturmi ai që do të ekuilibrojë një situatë yjore shumë të pastabilizuar, për shkak të kontrastit të dyshes, Uran-Pluton. Raportet ndërpersonale lenë për të dëshiruar.
- Peshorja** Janë një mori planetesh në shenjë tuaj që ju mbështesin, por mjafton që saturni të jetë i paqëndrueshëm në shenjë për t'ju ngatëruar edhe juve. Nuk është momenti për t'ju grindur tani me partnerin.
- Akrep** Tashmë Saturni pozitiv është plotësisht në shenjë tuaj dhe janë të gjitha gjasat që të qëndrojnë gjatë, prandaj do të keni një mbështetje të sigurt për pozitat tuaja në shoqëri. Mirë edhe dashuria.
- Shigjetari** Edhe një herë ju këshillohet që gjatë ditës personale nuk duhet t'i zvarritni por t'u jepni zgjidhje me më parë, për të mos komplikuar të ardhmen. Nuk është çudi të keni një njohje të re dhe interesante.
- Bricjapi** Janë Merkur dhe Afërdita ata që e gjallërojnë shumë jetën tuaj, por nga ana tjetër mund të stimulojnë xhekozitë, që mund të bëhen shkak edhe për sherre. Hëna ju bën më optimistë.
- Ujori** Në aspektin sentimental do të jetë një ditë e mrekullueshme, pasi Afërdita është në një orbitë që favorizon së tepërmi kontaktet dhe pasionet. Mund të keni ndonjë problem të vogël shëndeti.
- Peshqit** Duhet të këmbëngujni më shumë nëse dëshironi të shihni të realizuar një projekt tuajin, ndryshe, do të jeni të shtërngur të hiqni dorë përfundimisht. Pak më të matur me partnerin.

SUPER FJALEKRYQ

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19			
20								21		22		23	24			25	26		27		
28									29	30		31		32	33			34	35		
36				37				38		39			40			41	42		43	44	
45				46			47										48	49			
50							51							52			53			54	
55					56							57	58			59			60		
		61		62				63			64	65			66		67		68		
69	70			71							72			73		74			75		
		76		77				78		79	80	81			82			83		84	
85						86		87	88		89				90			91	92	93	94
95			96										98						99		

- HORIZONTAL**
1. Janë rolet e rralla në skenë.
 10. Fillojnë panikun.
 12. Kishte 100 Teba.
 15. Parajsja e humbur.
 18. Krijoi Arsene Lupin. (inic)
 20. Eshhtë ambalazhim.
 21. Një fjalë si bashkë.
 23. Një pjesë e akademikëve.
 25. Janë shkallë... shkencore.
 27. Fillon ndryshe.
 28. Janë tallës.
 29. Me të bëjnë një togë.
 31. Një ligën kripur.
 34. Janë caqe.
 36. Broën i Kodi i Da Vinci-t.
 37. Fillojnë turnin.
 38. Shkroi A Mademoiselle Zoë le Douairin.
 43. Thytet me dy kafshata.
 45. Një koeficient për shahistë.
 46. Ivan Reitman.
 47. Shkroi Mërzia.
 48. Efekti... i François Truffaut.
 50. Parshtesë zmadhuese.
 51. Michelangelo, regjisor i Blow-Up.
 52. Janë ata që kanë mall për kohët e shkuara.
 55. Institucione Lokale Rumune.
 56. Eshhtë koleg i Alvar Aalto.
 57. I ka tek nederi.
 59. Turner i CNN.
 60. Makashi këngëtar.
 61. Jennifer aktore.
 63. Fillojnë rubrikën.
 64. Një teolog në xhami.
 66. Janë cilësi.

68. Një pjesë e analogjisë.
69. Entë Autonome Fier.
71. Broën i Peanuts.
72. Ai i Charlie Broën është Snoopy.
73. Në mes të dhomës.
74. Bëjnë gica.
76. Shiroka i rilindasve.
78. Dy asa.
79. Kryeqyteti i Kansas.
82. Eshhtë krahinë e Athinës
83. Mirë në qendër.
85. Një aktore që premtan të bëhet yll.
87. Armstrong që thirrej Satchmo (inic).
89. Pavone këngëtare.
90. Tipat pa kufij.
91. Telly që interpretonte togeri Kojak.

- VERTIKAL**
1. Janë sëmundjet që përhapen.
 2. Sikur ke thënë krahas.
 3. Merret me studimin e imazheve të shenja.
 4. Një pjesë e senatorëve.
 5. Eshhtë sëundje veshësh.
 6. Një herë e një kohë.
 7. Dimër pa ekstreme.
 8. Carson i fumetti-t
 9. Fillojnë vonë.
 11. Dy asa.

12. Një veshje tipike tahitianësh.
13. Kufizojnë një treg.
14. Në krye të armatës.
15. Mihali soprano.
16. Një « miura » për arenë.
17. Hetim pa kufij.
18. I famshëm edhe ai i Tantalit.
19. Kufijtë e lëvizjes.
21. Makinë anglo-fraceze.
22. Shkruhet i shtati.
24. Mbolli Spartët.
26. Zbarkuan me D-Day.
27. Ishin nimfa si Teti.
30. Janë lagje segregacioni.
32. Dasmorë pa teke.
33. Mbreti i... Zodiakut

35. Një fjalë për matanë.
38. Qe mesfushori i yni.
39. Janë ndriçues.
40. U shkrua nga Shollohov.
41. Seksione Vendore Operative.
42. Eshhtë diellor me yll.
44. Gélonin nga gladiatorët.
47. Hidhet nga anijet në port.
48. Ndal në kufij.
49. Kështu janë smuadrat që vetëm sulmojnë.
51. Emër vajze.
53. Një firmë e famshme produktesh sportive.
54. Një pjesë e kontekstit.
56. Kështu flet ai që qorton.
57. U shkrua nga Zola.
58. Një pjesë e emisioneve.
62. Ai që... është ndryshe.
65. Eshhtë një gjynah.
66. Hidhen për të zgjedhur.
67. Fillojnë tokëzimin.
70. Eshhtë edhe ajo epizootike.
75. Nuk i tregohen babait.
77. Larmi, kur s'është ai.
80. Gjysmë oreksi.
81. Kodi i kartës së celularit.
82. Një pjesë e aparateve.
84. Pak paralelizma.
85. Të parat në stadium.
86. Në krye të tolerantëve.
88. Kështu fillon një argument.
90. Fise pa fe.
92. Fillojnë afrimin.
93. Nota e diapazonit.
94. Fillojnë sette.

PERGJIGJET E NUMRIT TE DJESHEM

H	I	P	O	T	E	Z	A	T		P	A	K	N	A	N	T	E	S		P	A	R	A	D	E		
A	R	I	Z	O	N	A			N	O	S	T	R	A	D	A	M	U	S		N	G	A	D	A	L	E
S	E	R	T	I	N		P	A		B	I	Z	O	N	E	T		R		E	P	A	R	A			
A	N	A	L	I	Z	A		N	E	V	E	R	I	T	E	S	E		U	R	A		L	O	R	D	
P	E	T	A	L	E		P	I	R	O	M	A	N	E	T		Z	O	N	A		C	A	R	M	E	N
I	E	J	A			M	E	K	A	N	I	K	E	T		H		E		E	D	I	T		L	D	
G	M		A	R	K	E	T	A	R	E	T		R	E	B	E	L	I		D	E	L	L	I			
M	A	R	I	K	A		I	L	I	R	E	T		S	I	B	E	L	I	U	S		E	T	N	I	K
A	Z	A		I	R	O	N		V	O	T	A	T		R	R	L		S	U	R		A	T	I		
N	E	M	O		O	R		T	E	L		T	O		S	E	B	E	P		L	E	A	R	J	M	
E	T	O		I	N	I	E	S	T	A		P		D	U	E	R	O		M	E	R	I	M	E		
T	A	N	G	O		Z	T			A	R	I	E	T		R	Y	A	N		D		M	A	T	T	

**LAJME
NGA BOTA**

■ Norvegjia blen aeroplanë luftarakë nga SHBA

Ministria e Mbrojtjes e Norvegjisë njoftoi të premten se ka porositur dy aeroplanët e saj të parë luftarakë F-35 nga SHBA-ja, si pjesë e një marrëveshjeje në vlerë prej 10 miliardë dollarësh për dhjetëra avionë luftarakë të rinj, që do të zëvendësonin flotën e saj të vjetër të avionëve F-16. Ministri i Mbrojtjes, Espen Bart Eide tha se aeroplanët e rinj pritet t'i bashkohen forcës ajrore të Norvegjisë në vitin 2015. Bart Eide tha se kjo ishte blerja më e madhe e bërë ndonjëherë nga Norvegjia, që është shtet anëtar i NATO-s.

■ Libia shfuqizon ligjin "anti-Gaddafi"

Gjykata e Lartë e Libisë shfuqizoi një ligj që kriminalizonte glorifikimin e ish-identit Muammar Gaddafi, regjimit, ideve dhe djemve të tij. Gjykata vlerësoi se neni 37 i kushtetutës, i miratuar nga qeveria e përkohshme në muajin maj, ishte antikushtetues. Disa këshilla për të drejtat e njeriut në vend, grupe të shoqërisë civile e disa organizata ndërkombëtare apeluan kundër ligjit në fjalë. Nëse ligji do të hynte në fuqi, vlerësimi apo glorifikimi i regjimit e vetë diktatorit do të ishte i ndëshkueshëm me burgim. Ndonëse në ligj nuk ishte parashikuar masa e dënimit, ndërtimi i Kodit Penal Libian do të bënte që dënimi të varioje nga 3-15 vjet burg.

■ Kapet japonezi i arratisur i kultit Aum Shinrikyo

Policia japoneze ka arrestuar të arratisurin e fundit të kultit Aum Shinrikyo, duke i dhënë fund ndjekjes 17 vjeçare. Katsuya Takahashi dyshohet se është përfshirë në sulmin me gaz nervor të kryer në vitin 1995 në sistemin e metrosë së Tokios, duke shkaktuar vdekjen e 13 personave. Policia e ka verifikuar identitetin e tij pasi e kishte arrestuar pranë një kafeneje në Tokio. Takahashi ka qenë në arrati që nga sulmet e 17 vjetëve me parë, me ç'rast ishin lënduar rreth 6000 persona të tjerë.

■ Moskë "s'përfshihet në rrëzimin e regjimeve"

Ministri i Jashtëm Sergei Lavrov tha se Rusia nuk po marrë pjesë në diskutimet me Shtetet e Bashkuara ose vendet e tjera në lidhje me një transformim politik në Siri, që do të përfshinte largimin e presidentit Bashar al-Asad nga detyra. Lavrov tha të premten se kishte "lexuar diku" se Shtetet e Bashkuara dhe Rusia kanë diskutuar për një Siri post-asadiane. "Kjo nuk është e vërtetë", tha Lavrov, duke shtuar se Moskë "nuk përfshihet në përmbyesjet e regjimeve". Ministri i Jashtëm francez Laurent Fabius tha të premten se ai beson se Rusia është e shqetësuar se kush mund të vijë në pushtet pas rrëzimit të Asadit.

■ Shpërthim në Kandahar, 11 të vrarë

Një shpërthim në një treg në pjesën jugore të Afganistanit raportohet se ka lënë të vdekur të paktën 11 njerëz dhe ka plagosur 11 të tjerë. Autoritetet thanë se shpërthimi ndodhi sot në rrethin e largët të Marufit në provincën e Kandaharit. Vrasjet ndodhën, pasi që mjeti shpërthyes i bashkangjitur në një motor u aktivizua. Askush nuk ka marrë përgjegjësinë.

■ "Ditë të rrezikshme" e presin Egjiptin

Vëllazëria Myslimane ka paralajmëruar se Egjipti po përballë me "ditë të rrezikshme", pasi që Gjykata e Lartë Kushtetuese ka shpërbërë parlamentin e mbizotëruar nga islamistët. Gjykata - e përbërë nga gjyqtarë të emëruar nga ish presidenti Hosni Mubarak para përmbyesjes së tij në vitin e kaluar - gjithashtu mbështeli të drejtën e ish kryeministrit Ahmed Shafik, në kohën e Mubarakut, për të vazhduar garën e tij për president. Vendimet u morën para zgjedhjeve të fundjavës në balotazhin presidencial midis Shafikut dhe kandidatit të Vëllazërisë Myslimane, Muhamed Morsi.

VALË UHF
NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER



DIGITALB
KANALI 50
Do na ndiqni në të gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

Mund ta ndiqni A1-Report në këto televizione kablore:

NE SHQIPERI

Televizioni	Qyteti
WDR	Korçë
Intel Media	Fier
Inkuast	Pogradec
TVM Devoli	Devoli
Vjosa	Vlorë
Toskëz	Lushnjë
Bradat	Elbasan
Erzeni	Shijak
Luna	Kavajë
Mariusho	Bullgjeze
Permeti	Permet

Iria	Berat
Policani	Elbasan
Stazë Iriti & Suti	Fier
Kombi	Lushnjë
Lushnja	Prrinjas
Prrinjas	Tirane
Alfa Kabele	Fier
Cakran	Kutovë
Kutovë	Lapardhaja
Brado	Elbasan
Onkumi	Vlorë
Asparag	Rrogzohine
Mali	Mat

Kukesi	Kukes
Oresh	Fier
Maqellara	Diber
Multivizion	Kavajë
Tata Junior	B.Curri
Dijvaka	Lushnjë
M&G	Elbasan
Ura Vajgurore	Berat
Saranda Digital	Sarandë
Pupa	Lushnjë
Roskovec	Fier
HS-CA	Peashkopi
Eri A&A	Balsh
Illiria	Berat

NE MAQEDONI

Reçi KGM	Lezhe
S3	Tirane
Ju-El	Kruje
Manurras	Las
Manastri	Fier
Beshi	Elbasan
ARD&NET	Fier

Së shpejti...

**TELEVIZIONI
MË I RI
INFORMATIV
NË SHQIPËRI**



Redaksia & Marketing

Rruga: "Dervish Hima",
Tërë kullat, kulla e dytë, Tiranë
mobile: +355 69 60 60 421
marketing: +355 69 60 60 419

Studiot e prodhimit A1
Rruga: "Aleksandër Moisiu"
ish-Knostudio Shqipëria Sot

A1 REPORT!

origjina e lajmit...

Lajmi në High Definition

Jemi një grup mediatik i pavarur nga çdo parti në të cilin rregullat profesionale të informacionit mbizotërojnë mbi luftërat politike

• Alba Malltezi
Drejtoresh e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtoresh e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani
Kryeredaktor

• Politika: Jakin Marena
• Sociale: Esmeralda Keta
• Ekonomia: Genc Kondi
• Kulturë: Admirina Peçi
• Kronika: Elton Qyno

• Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
• Website: Suela Gera
Indri Maraku

• Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

• Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
Cel: +355696060418